



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Këshillin e Lartë të Prokurorisë”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“AUDITIM FINANCIAR NË**

**KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË”**

**Tiranë, Maj 2024**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	7
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	7
2.	Identifikimi i çështjes	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7-8
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standardet e auditimit	8
7.	Metodat e auditimit	8-9
8.	Dokumentimi i auditimit	9
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	9-10
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9-10
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	10
2.1	Veprimtaria e Zyrës së Këshillit të Lartë i Prokurorisë për periudhën objekt auditimi	10-16
2.2	Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit - Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit - Realizimi i planit të buxhetit	16-32
2.3	Auditimi i llogarive vjetore -Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. -Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. -Opinionimi mbi pasqyrat financiare të vitit 2022	32-47
2.4	Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit	47-52
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	53-57
<b>V</b>	<b>ANEKSE</b>	57-60

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **1.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*këtu e më poshtë KLP*) është institucioni përgjegjës për emërimin, vlerësimin, rritjen në detyrë dhe transferimin e prokurorëve të të gjitha niveleve; vendosjen për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve; propozimin në Kuvendi për kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit; miratimin e rregullave për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre; propozimin dhe administron buxhetin e tij; informimin e publikut dhe Kuvendit mbi gjendjen e prokurorisë. KLP është një institucion i ri Kushtetues, i cili është konstituuar me Vendimin Nr.1 të anëtarëve të KLP-së datë 19.12.2018 “Për Krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë” dhe funksionon në zbatim të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”- i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij. KLP është organ kolegjal, i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë për pesë vite. KLP është institucioni i pavarur, financimi i tij kryhet nga buxheti i shtetit ku për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në masën 150,896 mijë lekë ose 95% e total buxhetit të planifikuar, për vitin 2022 është në masën 149,821 mijë lekë ose 99% e total buxhetit të planifikuar ndërsa për vitin 2023 është në masën 200,916 mijë lekë ose 99% e total buxhetit të planifikuar.

Me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, KLP ka miratuar strukturën organizative të administratës me 65 numër punonjësish. Me Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” të ndryshuar me Vendimin Nr.183, datë 22.06.2023 është miratuar struktura organizative me 72 numër punonjësish.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit të veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme: veprimtaria e Zyrës së KLP-së; zbatimi i kriterëve në planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, realizimi i planit të buxhetit; auditimin e llogarive vjetore, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare dhe dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të vitit 2022; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

### **1.2 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi në terren.**

*Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi në terren vijojnë si më poshtë:*

**I.** Nga verifikimi i procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurta të realizuar pranë KLP-së në zbatim të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr. 171, datë 14.12.2022 rezultoi se:

-Përbërja e komisionit për inventarizimin e aktiveve për 2 vite radhazi ka qenë e njëjtë për 4 nga 5 anëtarët, kjo në kundërshtim me pikën 84, të UMF nr.30/2011, ku përcaktohet se: *“Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision”...*

**II.** Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit rezultoi tejkalim i afateve për kryerjen e pagesave dhe mos respektim i parimit FIFO. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga thesari rezultojnë se për vitin 2022 dhe vitin 2023 janë 20 raste ose 4 % e total transaksioneve të likuiduara jashtë afatit 30 ditorë dhe 50 raste ose 10% e total transaksioneve të likuiduara jo në respektim të rregullit hyrje e pare dalje e pare. - gjatë vitit 2022 janë kryer afërsisht 230 transaksione nga këto konstatohet se 17 raste ose 7 % e total transaksioneve janë likuiduar përtej afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik.

**III.** Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se: Në strukturën organike të KLP-së miratuar me Vendimin Nr. 36, datë 06.03.2019 të KLP dhe Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 të ndryshuar, nuk është përfshirë struktura e Auditit të Brendshëm, si njësi më vete.

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:*

**Rekomandimi 1.1** Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ngritjen e një komisioni për saktësimin e gjendjes së inventarit dhe në rastet e mungesave të evidentohen personat përgjegjës dhe të bëhen veprimet kontabël rregulluese të bazuara në urdhrin e Nëpunësit Autorizues.

**Rekomandimi 1.2** Nga Nëpunësi Zbatues, duhet që në regjistrimin e gjendjes reale të aktiveve, në kundër parti, të mungesave të aktiveve, të njihen të drejtat ndaj personave përgjegjës për mungesat, bazuar kjo në Urdhrin e Nëpunësit Autorizues.

**Rekomandimi 2** Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të merren masa për sigurimin e likuiditetit të mjaftueshëm me qëllim financimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore dhe ekzekutimit të tyre në procesimin normal të ciklit të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore duke respektuar afatet, radhën dhe prioritet e pagesave buxhetore.

**Rekomandimi 3** Të merren masa nga KLP për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm dhe nëse, nuk plotësohen kushtet e parashikuara në VKM Nr.83 Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, në pikën 6 germa a) bazuar dhe në Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar neni 3, germa “a”, si dhe neni 10, pika 1, germa “b” të bashkëpunohet me njësi Auditit të Brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse, në mënyrë që i gjithë sistemi i MFK-së të funksionojë me efektivitet.

### 1.3. Opinioni i Auditimit.

#### **Opinion mbi auditimin financiar (I pamodifikuar, me theksim të çështjes)<sup>1</sup>:**

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP), për vitin ushtrimor nga 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

#### **Opinion:**

Pasi kemi siguruar evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme, arrihet në përfundimin se PFV, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit më 31 dhjetor 2022, referuar (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimet e MF mbi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, etj.) mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare që justifikojnë dhënien e një opinionit të pakualifikuar/pamodifikuar me theksim të çështjes.

#### **Baza për opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, të miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së miratuar me Vendimin Nr.56, datë 30.04.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Ne besojmë se evidencat e marra gjatë auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit **të pamodifikuar me theksim të çështjes.**

Nën gjykimin profesional të audituesit është marrë në konsideratë niveli i përllogaritur i materialitetit për vitin 2022 (në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tu audituar në vlerën 1,418,867 lekë për tu konsideruar) pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin se sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar për faktin se: pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare që janë përgatitur e raportuar në përputhje me kuadrin rregullativ në fuqi, si dhe kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

#### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen e menaxhimit të lartë të institucionit për faktin se:

Për mungesat nga procesi inventarizimit të Aktiveve Afat Shkurtra dhe Aktiveve Afat Gjata rezultoi se nga ana e Nëpunësit Autorizues nuk është nxjerrë urdhri për ndjekje nga Nëpunësi

<sup>1</sup> Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII pika 4.1. *Një opinion me “Theksim Çështjeje”*, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

Zbatues, në lidhje me masat për kompensim dhe sistemimin e diferencave, kjo në kundërshtim me pikën 87 dhe 93, të UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”- i ndryshuar. Mungesat në zërat e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, të rezultuara nga inventarizimi fizik në shumën 370,614 lekë. Kjo shumë është hequr nga vlera e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar dhe nga regjistri aktiveve, ku mbarten vetëm emërtimet e tyre, mirëpo sistemimet e bëra nga nëpunësi zbatues nuk janë mbështetur në dokumentacionin justifikues, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit 35 të UMF Nr.30, datë 27.1.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” rezulton e mbivlerësuar pasi në listën analitike të kësaj llogarie janë përfshirë 3 artikuj, të cilët nuk zotërohen nga KLP, por janë të marra me qira e si të tilla nuk duhet të ishin pjesë e Llogarisë 218, prej përfshirjes së këtyre zërave në listën analitike, të Llogarisë 218, vlera kontabël neto e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 mbivlerësohet me 200,441 lekë dhe shpenzimet e amortizimit për këtë vit mbivlerësohen me 28,822 lekë.

#### ***Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Subjektit***

Strukturat drejtuese të KLP, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes së paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”- i ndryshuar, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Titullari i Institucionit/Sekretari i Përgjithshëm (në cilësinë e Nëpunësit Autorizues), janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar

#### ***Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së për auditimin e PFV***

Përgjegjësia audituesve të KLSH-së, është që të shprehë një opinion për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Nr.104/1 Prot, datë 29/01/2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01/02/2024 deri në datë 29/03/2024, në subjektin Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*këtu e më poshtë KLP*) u krye auditimi financiar për periudhën nga 01/01/2021 deri në 31/12/2023 nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.N. M,       përgjegjës grupi;
- 2.M. H,       audituese;
- 3.E. C,       audituese;
- 4.K. N,       audituese;

## **OBJEKTIVAT, FUSHË VEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1.Objekti dhe qëllimi i auditimit.**

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit financiar me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021-2023 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të KLP-së, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar. Auditimi financiar ka si qëllim vlerësimin nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Nga auditimi synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve financiare, gjatë veprimtarisë së tij. Auditimi synon gjithashtu dhënien e opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së KLP-së.

### **2.Identifikimi i çështjes.**

Raporti përfundimtar mbi auditimin financiar të veprimtarisë së KLP-së, referuar programit të auditimit për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, ka identifikuar çështjet si më poshtë:

- Veprimtaria e Zyrës së KLP-së për periudhën objekt auditimi
- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit
- Auditimi i llogarive vjetore
- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

### **3.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Strukturat drejtuese të KLP-së, kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

### **4.Përgjegjësitë e audituesve.**

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar KLP-së është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç

standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-se, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

-Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;

-Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

### **5.Kriteret e vlerësimit.**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”- i ndryshuar;

-Ligji Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Ligji Nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” ;

-Ligji Nr. 115/2021, datë 25.11.2021“Për buxhetin e vitit 2022” ;

-Ligji Nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” ;

-Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”-i ndryshuar;

-Udhëzimi MF Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”-i ndryshuar;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”-i ndryshuar;

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

### **6.Standardet e auditimit.**

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 200 (*Parime themelore të auditimit financiar*);

-ISSAI 100 (*Parime themelore të auditimit të sektorit publik*), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;

-Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.246, datë 29.12.2022;

-Praktikat më të mira të fushës;

### **7.Metodat e auditimit.**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. *Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;



c. Verifikimi në sistem dhe në terren- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

e. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH-së janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

### **8. Dokumentimi i auditimit.**

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e KLP-së, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij raporti përfundimtar auditimi.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është një institucion i ri Kushtetues dhe funksionon në zbatim të Ligjit Nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"- i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij. Ai është konstituar me Vendimin Nr.1 të anëtarëve të KLP-së datë 19.12.2018 "Për Krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë" në mbështetje të neneve 149 dhe 179, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 280 të Ligjit Nr. 115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 19/2018 "Për zgjedhjen e anëtarëve të KLP", dhe të Vendimit datë 11.12.2018 të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve "Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve". KLP është organ kolegjal, i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë për pesë vite. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorisë. Pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë jo prokurorë, të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të drejtësisë dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Anëtarët prokurorë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve të gjitha niveleve. Anëtarët jo prokurorë që zgjidhen nga radhët e avokatëve, trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe shoqërisë civile zgjidhen nga Kuvendi, bazuar në një proces vlerësimi paraprak të kushteve dhe kriterëve ligjore, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Anëtari i KLP-së ka statusin e magjistratit, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"-i ndryshuar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj. Pasi zgjedh Kryetarin e KLP-së nga radhët e anëtarëve jo prokurorë, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë:

- Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit;
- Komisioni Disiplinor;
- Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;
- Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Objekti i veprimtarisë së KLP-së është garantimi i pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), është institucioni përgjegjës për:

- emërimin, vlerësimin, rritjen në detyrë dhe transferimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;
- vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
- miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;-
- propozon dhe administron buxhetin e tij;
- informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj;

Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë funksionon administrata, e cila ndihmon në realizimin e misionit dhe të funksioneve të Këshillit. Administrata e Këshillit drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe raporton rregullisht tek ai. Sekretari i Përgjithshëm i KLP-së është funksionari më i Lartë administrativ i Këshillit. KLP financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjisllacionin përkatës ku për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në masën 150,896 mijë lekë ose 95% e total buxhetit të planifikuar, për vitin 2022 është në masën 149,821 mijë lekë ose 99% e total buxhetit të planifikuar ndërsa për vitin 2023 është në masën 200,916 mijë lekë ose 99% e total buxhetit të planifikuar.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:**

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 104/1, datë 29.01.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në KLP u ushtrua auditim financiar për periudhën 01.01.2021- 31.12.2023, sipas drejtimeve:

- 2.1 Veprimtaria e Zyrës së Këshillit të Lartë i Prokurorisë për periudhën objekt auditimi
- 2.2 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit
- 2.3 Auditimi i llogarive vjetore
- 2.4 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

### **2.1 Veprimtaria e Zyrës së Këshillit të Lartë i Prokurorisë për periudhën objekt auditimi**

Në zbatim të pikës II/1 “*1.Veprimtaria e Zyrës së Këshillit të Lartë i Prokurorisë për periudhën objekt auditimi*” të programit të auditimit Nr. 104/1, datë 29.01.2024”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Manual i Përshkrimit të Punëve “Në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;
- Manual i Përshkrimit të detyrave në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Raport Vjetor 2021 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë miratuar me Vendimin Nr. 55, datë 28.03.2022 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Raport Vjetor 2022 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë miratuar me Vendimin Nr. 89, datë 24.04.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligj Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar.
- Vendim Nr.36, datë 06.03.2019 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;
- Vendimin Nr.150, datë 22.07.2019 “Për Miratimin e Detyrave dhe Përgjegjësiive të Njësiive Organizative të Administratës së KLP-së”;
- Vendim Nr. 407, datë 17.12.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;

- Vendim Nr.73, datë 24.04.2023 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;
- Vendim Nr.183, datë 22.06.2023 për “Një ndryshim në Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;
- Vendim Nr.405, datë 28.12.2023 Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;

Nga auditimi:

Bazuar në Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar në Nenin 176 , 177, 178 pranë KLP-së funksionon administrata, e cila ndihmon në realizimin e misionit dhe të funksioneve të Këshillit. KLP financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, buxheti është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjisllacionin përkatës. Administrata e Këshillit drejtohet nga Kryetari i KLP-së dhe raporton rregullisht tek ai. Sekretari i Përgjithshëm i KLP-së është funksionari më i lartë administrativ i Këshillit. Administrata e KLP-së ndahet në njësitë e mëposhtme:

- njësi mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike;
- njësi mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të Këshillit;
- njësi mbështetëse për administrimin e buxhetit të Këshillit;
- zyra e Këshilltarit të Etikës;
- njësi mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet;
- njësi mbështetëse për teknologjinë e informacionit;
- njësi mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë.

Në lidhje me administratën, Këshilli vendos për sa më poshtë:

- strukturën e administratës dhe të secilës njësi;
- krijimin e njësive të tjera organizative brenda administratës;
- përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha njësive organizative të administratës dhe të pozicioneve individuale;
- rregullat procedurale, sipas të cilave vepron administrata, në mënyrë të atillë që të sigurojë mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, KLP ka miratuar strukturën organizative të administratës me 65 numër punonjësish në përputhje me Nenin 178 pika 2 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar, ku janë përcaktuar qartë mënyra e organizimit dhe njësitë mbështetëse të administratës së KLP-se. Në fund të Vitit 2021, në KLP ka patur 62 punonjës faktik nga 65 punonjës të miratuar në organikë. Në zbatim të Ligjit Nr. 115/2016“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar në Nenin 178 pika 2 dhe Nenin 189 germa “ç” KLP ka miratuar “*Manualin për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë*” dhe “*Manualin për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë*” me Vendimin Nr.150, datë 22.07.2019 “Për Miratimin e Detyrave dhe Përgjegjësive të Njësive Organizative të Administratës së KLP-së”.

Sipas Ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar dhe Manualit, objekti i veprimtarisë së KLP-së është garantimi i pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

KLP përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve jo prokurorë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

- emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve
  - vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve
  - i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit
  - miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre
  - propozon dhe administron buxhetin e tij
  - informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë
  - ushtron funksione të tjera të caktuara në ligj
- Ndërsa Struktura e KLP-së është si më poshtë:

- Kryetari;
- Zëvendës Kryetari;
- Anëtarët e KLP-se;
- Drejtori i Kabinetit;
- Sekretari i Përgjithshëm
- Njësia Mbështetëse e Komisioneve;
- Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtor Ekonomik dhe Burimeve Njerëzore;

Me Vendimin Nr.407, datë 17.12.2021 është miratuar rregullorja “Për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” qëllimi i të cilës është të përcaktojë rregulla dhe procedura të hollësishme për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë normale të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të misionit të tij Kushtetues. Me Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” të ndryshuar me Vendimin Nr.183, datë 22.06.2023 është miratuar struktura organizative me 72 numër punonjësish. Strukturë e cila ka qenë në fuqi deri në vitin 2023.

Me Vendimin Nr.405, datë 28.12.2023 është miratuar Rregullorja “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” pasi për periudhën 2019-2023 funksionin e Rregullores e ka kryer “Manuali për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë” miratuar me Vendimin e KLP-së Nr.150, datë 22.07.2019 “Për Miratimin e Detyrave dhe Përgjegjësi të Njësive Organizative të Administratës së KLP-së”.

Në rregullore është sanksionuar roli dhe funksionimi i administratës së KLP-së, parimet e funksionimit, organizimi dhe drejtimi i administratës, struktura dhe kompetencat e drejtorive përbërëse. Komisionet e përhershme të KLP e ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime në fushat e parashikuara si edhe ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit, në përputhje me Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar në Nenin 159, Nenin 160 dhe Vendimin Nr. 407, datë 17.12.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” në Nenet 40 , 41, 42, 43.

KLP , pasi zgjedh Kryetarin, merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Çdo komision përbëhet nga tre anëtarë dhe pranë çdo komisioni caktohen edhe 2 anëtarë zëvendësues. Në çdo rast një anëtar prokuror mund të zëvendësohet vetëm nga një anëtar tjetër prokuror. Një anëtar jo prokuror mund të zëvendësohet vetëm nga një anëtar tjetër jo prokuror. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta.

KLP ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë:

1) Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i cili përbëhet nga 2 anëtarë jo prokurorë dhe 1 anëtar prokuror.

Ky Komision ka si objekt të veprimtarisë së tij, çdo çështje që ka lidhje me:

-hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit strategjik, në përputhje me objektivat e ligjit për qeverisjen dhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë;

-hartimin e planit të veprimit, i cili shoqëron planin strategjik, përfshirë objektivat operacionale, veprimtaritë, ndikimin financiar dhe ndikime të tjera, si dhe treguesit e arritjeve;

-hartimin e projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Këshillit, në konsultim me Ministrinë e Financave;

-hartimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit, në koordinim me komisionet e tjera; i cili përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe Komisioneve të tij;

-propozon strukturën organizative të administratës së Këshillit;

-i propozon Këshillit, miratimin e kërkesave të magjistratëve prokurorë për veprimtaritë jashtë funksionit, si dhe harton dhe publikon një raportim vjetor lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit, të paguara, të magjistratëve;

-i propozon Këshillit miratimin e lejeve të papaguara për magjistratët;

-harton aktet nënligjore me karakter financiar në zbatim të ligjit për statusin;

-propozon për miratim në Këshill, emrat e anëtarëve të Bordit të QTID-së;

-ndjek procedurën për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit, në Komisionin e Mbrojtjes së Prokurorëve

-propozon për miratim në Këshill, anëtarin e Komisionit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

-të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij Komisioni.

2) Komisioni Disiplinor i cili përbëhet nga 2 anëtarë prokurorë dhe 1 anëtar jo prokuror.

Ky Komision ka si objekt të veprimtarisë së tij, trajtimin e çdo çështjeje që ka lidhje me procedurat me natyrë disiplinore, të parashikuara në ligjin për statusin, si vijon:

-ankimin e prokurorit ndaj mosveprimit administrativ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 115, të ligjit për statusin;

-ankimin ndaj vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dënimin me gjobë, sipas nenit 132, pika 4 e ligjit për statusin;

-shqyrtimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore dhe të ankimit ndaj mosveprimit administrativ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas nenit 135 të ligjit për statusin;

-shqyrtimin e procedimeve disiplinore, të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas neneve 138 deri në 147, të ligjit për statusin, dhe, kur është rasti, propozon marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligjin për statusin;

-marrjen e të gjitha masave të nevojshme dhe sigurimin e zbatimit dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor;

-pezullimin e detyruar të magjistratit prokuror nga detyra, në bazë të nenit 151, të ligjit për statusin;

-pezullimin e magjistratit, ndaj të cilit është paraqitur një kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 152 të ligjit për statusin, kryesisht apo mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Komisioni Disiplinor është kompetent edhe për çdo çështje tjetër të parashikuar me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij Komisioni.

-Hartim dhe ndryshimin e akteve nënligjore, të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së Komisionit.

3)Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale i cili përbëhet nga 2 anëtarë prokurorë dhe 1 anëtar jo prokuror.

4) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i cili përbëhet nga 2 anëtarë prokurorë dhe 1 anëtar jo prokuror.

Konstatohet se secili komision i përhershëm ka paraqitur në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse , si edhe janë publikuar në faqen zyrtare të KLP-së, në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 16 të Nenit 160 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar.

Në përputhje me Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar në Nenin 181, KLP raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik jo më pak se një herë në vit. Raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme. Raporti i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë të detyrueshme për t’u marrë parasysh nga Këshilli, për aq sa nuk cenojnë pavarësinë e këtij institucioni. Për veprimtarinë e KLP për vitin 2021, më datë 31.03.2022 brenda afatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar në Nenin 181 pika 2 , Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka paraqitur Raportin Vjetor për vitin 2021 në Kuvend të miratuar me Vendimin Nr. 55, datë 28.03.2022 të KLP. Ky raport është publikuar ne faqen zyrtare të KLP. Raporti është i ndarë në shtatë kapituj, ku në kapitullin e parë, trajtohen ndryshimet që ka pësuar KLP-ja në përbërjen e saj gjatë vitit 2021, si dhe aktiviteti i KLP-së në mbledhje plenare. Në kapitullin e dytë, jepet një analizë më e detajuar të aktivitetit të komisioneve të përhershme të KLP-së, të komisioneve të posaçme dhe atyre ndërinstitucional. Secili prej komisioneve të përhershme, ka paraqitur përpara KLP-së veprimtarinë e tij për vitin 2021 duke pasqyruar ecurinë e punës, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Komisioni i Planifikimit Strategjik, të Administrimit dhe Buxhetit ka propozuar marrjen e vendimeve në lidhje me mirë organizimin e fondeve buxhetore për vitin 2021, miratimin e kërkesave buxhetore për vitet 2022-2024, vendime të tjera në kuadër të veprimtarisë së Komisionit. Në total, 21 vendime të KLP janë propozuar dhe trajtuar nga Komisioni i Buxhetit, në ushtrim të kompetencave të veta.

Në kapitullin e tretë, detajohet veprimtaria administrative dhe financiare e KLP-së. Bazuar në të dhënat e raportit, buxhetin vjetor i KLP-se është miratuar në vlerën 159,150 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 150,896 mije lekë. Në kapitullin e katërt janë trajtuar marrëdhëniet ndërinstitucionale që KLP-ja ka me Kuvendin, Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Prokurorinë e Përgjithshme, dhe me Institucionet e Rivlerësimit. Në kapitullin e pestë trajtohet transparenca në vendimmarrje e KLP-së dhe raporti me mediat. Dy kapitujt e fundit i kushtohen nivelit të zbatimit të rezolutës së Kuvendit “Për raportin vjetor të KLP-së për vitin 2020”, konkluzionet që mund të nxirren nga veprimtaria e vitit 2021,si dhe prioritetet e KLP-së për vitin 2022.

Për veprimtarinë e KLP për vitin 2022, më datë 24.04.2023 brenda afatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar në Nenin 181 pika 2 Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka paraqitur Raportin Vjetor për vitin 2022 në Kuvend të miratuar me Vendimin Nr. 89, datë 24.04.2023 të KLP. Ky raport është publikuar ne faqen zyrtare të KLP. Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë vitit 2022, ka marrë gjithsej 333 vendime, në 35 mbledhje plenare të zhvilluara. KLP-ja ka pasur në vëmendje dhe ka punuar për hartimin dhe miratimin e

disa akteve nënligjore si: Rregullorja për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median , Rregullorja për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm , Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve , Standardet e etikës dhe sjelljes së prokurorëve , Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Bazuar në të dhënat e raportit, buxheti vjetor i KLP-se për 2022 është miratuar në vlerën 150,552 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 149,821 mije lekë dhe Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit ka propozuar marrjen e vendimeve në lidhje me:

-Planifikimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet për fondet buxhetore për vitin 2022;

-Miratimin e kërkesave buxhetore për vitin 2023-2025;

-Miratimin e kërkesave për lejimin e veprimtarive jashtë funksionit për prokurorët;

Sipas raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, të Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2023, ky Komision ka realizuar veprimtarinë e tij në përputhje me Nenin 40 të Vendimit Nr. 407, datë 17.12.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” dhe Neni 160 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar , në këto drejtime:

-Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të planit strategjik, në përputhje me objektivat e ligjit për qeverisjen dhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë;

-Mirë organizimi i fondeve buxhetore për vitin 2023;

-Miratimi i kërkesave buxhetore për vitin 2024-2026;

-Aktet nënligjore me karakter financiar në zbatim të Ligjit Nr.96/2016, i ndryshuar;

-Procedura për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit, në Komisionin e Mbrojtjes së Prokurorëve;

-Miratimi i strukturës organizative të administratës së Këshillit;

-Veprimtaritë jashtë funksionit;

-Veprimtaria lidhur me deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarëve për të cilët është plotësuar afati ligjor 5 vjeçar;

-Miratimi i akteve nënligjore;

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:***

Në lidhje me *Veprimtarinë e Zyrës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën objekt auditimi* u konstatua se:


-Për vitin 2021 deri me Prill 2023, me Vendim Nr.36, datë 06.03.2019 është miratuar struktura organizative e administratës në përputhje me Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar, Neni 178, dhe me Vendim Nr.73, datë 24.04.2023 të ndryshuar me Vendimin Nr.183, datë 22.06.2023 është miratuar struktura organizative për 2023.

- Në përputhje me Ligjin Nr. 115/2016- i ndryshuar në Nenin 178 pika 2 germa “c” dhe Nenin 189 është miratuar “*Manuali për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë*” me Vendimin e KLP-së Nr.150, datë 22.07.2019 dhe për vitin 2023 “*Manuali për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë*” miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

- Me Vendimin Nr.405, datë 28.12.2023 është miratuar Rregullorja “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” në përputhje me Ligjin Nr. 115/2016- i ndryshuar neni 178 pika 2.

- Këshilli Lartë i Prokurorisë ka raportuar para Kuvendit brënda afatit, në përputhje me Ligjin Nr. 115/2016- i ndryshuar neni 181.

Struktura e KLP-së paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:



## 2.2 Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Për auditimin e pikës II/2 “**Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit**” të programit të auditimit Nr. 104/1, datë 29.01.2024, nën pikës 2.1 “Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit” dhe nën pikës 2.2 “Realizimi i planit të buxhetit” u shqyrtua dokumentacioni për periudhën objekt auditimi 2021-2023 si më poshtë:

1. Kërkesat buxhetore të buxhetit PBA I-rë, PBA II-të,
2. Shkresat përcjellëse për buxhetin, rialokim, shtesë fondi,
3. Projektet e investimit,
4. Rakordimet me Thesarin,
5. Çdo dokument mbi zbatimin e buxhetit,
6. Çdo dokument mbi monitorimin e buxhetit.

### **Nga auditimi ka rezultuar:**

Njësia përgjegjëse për planifikimin, hartimin dhe zbatimin e buxhetit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) është Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore. Kjo drejtori ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” deri me 24.04.2023. KLP ka miratuar strukturën e re me vendimin Nr. 73, datë 24.04.2023 “Miratimin e strukturës organizative të Administratës së KLP”, ndryshuar me vendimin Nr. 183, datë 22.06.2023. Kjo drejtori ka në përbërjen e saj dy sektor, sektori i financës (1+2), një përgjegjës



dhe dy specialist dhe sektori i Burimeve Njerëzore (1+3) një përgjegjës dhe tre specialist. Konstatohet se sektori i financës nuk ka patur vakanca gjatë periudhës objekt auditimi. Detyrat e kësaj drejtorie deri në 28.12.2023 janë të përshkruara me vendimin nr. 150, datë 22.07.2019 “Për miratimin e detyrave dhe përgjegjësi të njësi organizative të administratës së KLP-së” dhe në rregulloren e miratuar me vendimin Nr. 405, datë 28.12.2023 “Për organizimin dhe funksionim e administratës së KLP” neni 19. Konstatohet se kërkesat buxhetore për programin buxhetor afatmesëm dhe buxhetin vjetor janë hartuar dhe propozuar nga Komisioni i Buxhetit në zbatim të Ligjit për Qeverisjen, nenin 160, pika 3/a dhe në zbatim të rregullores së brendshme të KLP-së "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, neni 40.

### **Buxheti i vitit 2021**

#### *Përgatitja e PBA 2021-2023*

Hartimi i dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm PBA 2021-2023, prezanton kërkesat buxhetore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Me Urdhrin nr. 61 datë 26.06.2020 të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Urdhrin Nr. 62 datë 26.06.2020 është ngritur Grupi i Menaxhimit të Programit (EMP).

Me shkresën Nr. 115/1 Prot, datë 10.09.2021, KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2021-2023. Shpenzimet e personelit janë planifikuar në vlerën 119,917 mijë lekë sipas strukturës ekzistuese me 65 punonjës. Shpenzimet operative janë planifikuar në vlerën 41,000 mijë lekë për të mbuluar shpenzimet në lidhje me zhvendosjen në godinën “Poli i Drejtorisë” dhe shpenzimet e tjera operative. Shpenzimet kapitale janë planifikuar :

- në vlerën 19,000 mijë lekë për të blerë automjetet për anëtarët e KLP-së,
- blerje orendi, kasaforta në vlerën 800 mijë lekë,
- ndarje funksionale dhe izolimi i zyrave në vlerën 7,000 mijë lekë,
- arkivë digjitale në vlerën 3,000 mijë lekë.

Tabela 1. Pasqyra e kërkesave buxhetore PBA 2021-2023 (në mijë lekë)

Emërtimi	Viti buxhetor 2021		Viti buxhetor 2022		Viti buxhetor 2023	
	Kërkesa buxhetore	Tavani	Kërkesa buxhetore	Tavani	Kërkesa buxhetore	Tavan
Shpenz. Korrente	144,000	144,000	144,000	145,000	144,000	154,000
Shpenz. Kapitale	10,000	10,000	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>154,000</b>	<b>154,000</b>	<b>144,000</b>	<b>145,000</b>	<b>144,000</b>	<b>154,000</b>

*Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së*

Me shkresën Nr.1807/1 Prot, datë 30.12.2020 KLP ka dërguar pranë MFE, detajimin e buxhetit për vitin 2021-2023 në nivel programi në vlerë totale 164,000 mijë lekë duke shtuar kërkesat shtesë për financim. Konkretisht shpenzimet e planifikuara për shpenzime korrente në vlerën 147,000 mijë lekë dhe për shpenzime kapitale në vlerën 17,000 mijë lekë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vitin 2021,ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore vetëm për një program 01110-Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë i Prokurorisë. Burimi kryesor i financimit të KLP-së është buxheti i shtetit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk gjeneron të ardhura të tjera. Buxheti i vitit 2021 për KLP është miratuar me Ligjin Nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” në vlerën 164,000 mijë lekë. Nga ky buxhet, shpenzimet korrente të planifikuara në vlerën 147,000 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale në vlerën 17,000 mijë lekë. Me shkresën nr. 23724/118 Prot, datë 19.01.2021

është dërguar detajimi i shpenzimeve korrente nga MFE në vlerën 147,000 mijë lekë. Me shkresën Nr. 1690/1 Prot, datë 29.01.2021 është dërguar detajimi i shpenzimeve kapitale nga MFE në vlerën 17,000 mijë lekë. Konkretisht i detajuar si më poshtë sipas klasifikimit ekonomik:

- Llogaria ekonomike 600+601, shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për 65 punonjësi sipas strukturës janë planifikuar në vlerën 119,917 mijë lekë.

- Llogaria ekonomike 602, shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime në vlerën 27,083 mijë lekë.

- Llogaria ekonomike 231, shpenzimet e planifikuara për investime në vlerën 17,000 mijë lekë për të blerë automjetesh për anëtarët e KLP-së.

#### Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021 janë bërë disa ndryshime në buxhetin e KLP-së, konkretisht:

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues Nr.4, datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, në vlerën 150 mijë lekë.

-Me shkresën Nr.1180 Prot, datë 25.05.2021 është miratuar nga MFE kërkesa për transferim fondi, pakësim nga llogaria ekonomike 602 në vlerën 150 mijë lekë dhe shtim fondi në vlerë 150 mijë lekë në llogarinë 606.

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr.11616/35 datë 08.07.2021, ka përcjellë pakësimin e fondit sipas Aktit Normativ Nr.26, datë 26.06.2021”Për disa ndryshime në Ligjin Nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” në vlerën 5,000 mijë lekë nga llogaria ekonomike 600.

-KLP me shkresën Nr.2290/1, datë 21.10.2021, lënda “Kërkesë për rishpërndarje të fondeve buxhetore” ka kërkuar rishpërndarje të fondeve buxhetore, pakësim i llog ekonomike 600 në vlerën 7,000 mijë lekë dhe shtim fondi në llog. ekonomike 602 në vlerën 7,000 mijë lekë. Fondet e mbetura nga llogaria ekonomike 600 për shkak të vakancave në strukturë do të përdoren për të mbuluar shpenzimet operative që lidhen me vendosjen në ambientet e reja “Poli i Drejtësisë”. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr.18508/1 Prot, datë 02.11.2021, ka miratuar këtë kërkesë.

Tabela 2. Buxheti i vitit 2021 (në mijë lekë)

Emërtimi	PBA 2021-2023 Faza II	PBA 2021-2023, Faza III	Ligji i buxhetit të vitit 2021	Buxheti i ndryshuar
Shpenz. Korrente	144,000	147,000	147,000	147,150
Shpenz. Kapitale	10,000	17,000	17,000	17,000
Totali	154,000	164,000	164,000	164,150

*Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së*

Konstatohet se kërkesat për rishpërndarje fondi i plotësojnë të gjitha kriteret formale të përcaktuara në Udhëzimin Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat për zbatimin e buxhetit”, kreu “Rishpërndarje fondi”.

#### **Mbi realizimin e planit të buxhetit të vitit 2021**

Buxheti i vitit 2021 i alokuar me Ligjin Nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” për Këshillin e Lartë të Prokurorisë në fillim të vitit 2021, ishte 164,000 mijë lekë. Gjatë vitit, ky buxhet është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në vlerën 300 mijë lekë dhe pakësuar llogaria 602 me 150 mijë lekë. Buxheti i detajuar sipas llogarive është i pasqyruar në tabelën Nr. 2 “Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik”. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, ka miratuar strukturën organizative, në përputhje me nenin 178, të Ligjit për Qeverisjen.

Tabela 3. Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

Art.	Emërtimi	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	%
		Plan Viti 2021	Plan Fillestar Viti 2021	I rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimit
600	Paga	106,676	106,676	94,826	88,847	94%
601	Sigurime shoqërore	13,241	13,241	13,241	11,465	87%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	29,083	27,083	33,933	33,376	98%
606	Trans. Për Buxh. Fam. dhe Ind.			300	299	100%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	149,000	147,000	142,150	133,987	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	10,000	17,000	17,000	16,908	99%
	Shpenzime Kapitale	10,000	17,000	17,000	16,908	99%
	<b>Totali</b>	<b>159,000</b>	<b>164,000</b>	<b>159,150</b>	<b>150,896</b>	<b>95%</b>

Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Realizimi faktik për vitin 2021 është 150,896 mijë lekë, ose në masën 95% e total buxhetit të planifikuar dhe fondet e papërdorura në vlerën 8,234 mijë lekë.

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“Artikulli 600 + 601” - Buxheti vjetor i alokuar për *shpenzime personeli* është 108,067 mijë lekë i cili zë afërsisht 68% të total buxhetit. Realizimi faktik është 100,312 mijë lekë ose në masën 93% (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Numri i punonjësve të KLP-së i miratuar me ligj për vitin 2021 është 65 punonjës, ndërsa deri në 31 Dhjetor 2021 ka patur 62 punonjës faktik, pra ka një mungesë me 3 punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program në fillim të vitit ishte 27,083 mijë lekë, ndërsa vlera e buxhetit të rishikuar vjetor është 34,083 mijë lekë ose afërsisht 21 % e total buxhetit të rishikuar. Realizimi vjetor i fondeve buxhetore për shpenzime operative është 33,376 mijë lekë ose në masën 98%. Këto fonde janë përdorur në funksion të aktivitetit të KLP-së kryesisht për: shërbimet që kryhen nga Ndërmarrja Industriale nr.1 (shërbim pastrim dhe gjelbërim, shërbimi i ruajtjes, mirëmbajtje ashensori etje.) sipas akt-marrëveshjes Nr. 54/1 datë 17.12.2020, këto zënë afërsisht 45 % të total llogarisë 602. Pjesa tjetër e fondeve përdoren për blerje kancelarie, shpenzime transporti, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme etj. Masa e realizimit të shpenzimeve korrente 94 % e total buxhetit të planifikuar, tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet të fondeve buxhetore.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2021, ishte 150 mijëlekë. Sikurse u citua më sipër Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr. 8524/1 Prot, datë 20.05.2021, miratoi transferimin e fondit në vlerën 150 mijë lekë nga shpenzime operative (artikulli 602) në artikullin 606 “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*”. Fondi u planifikua për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për funksionarët përfutues. Buxheti i rishikuar vjetor i planifikuar në këtë artikull për vitin 2021 është 300 mijë lekë. Gjatë vitit është përdorur fondi në vlerën 299 mijë lekë ose në masën 99 %.

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program është planifikuar 17,000 mijë lekë ose 11 % e total buxhetit, për realizimin e projektit “Blerjen e 5 automjeteve” për anëtarët e KLP-ës. Realizimi faktik në artikullin 231 është 16,908 mijë lekë, ose në masën 99%. (të rakorduar edhe me sistemin SIFQ). Konstatohet se angazhimet buxhetorë të ndërmarrja gjatë vitit 2021 janë në përputhje më përcaktimet e Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50-52, dhe UMFE Nr. 9 datë 20.303.2018

“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kreu “E drejta për të kryer shpenzime”, nenet 79-83.

### **Verifikimi i respektimit të afateve të likuidimit të faturave për vitin 2021**

Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231). Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se gjatë vitit 2021 janë kryer afërsisht 335 transaksione. Konstatohet se marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve të ndërmarrja gjatë vitit 2021 nga KLP është në përputhje me udhëzimin Nr. 9 datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kreu “E drejta për të kryer shpenzime” dhe kreu “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe me Ligjin Nr. 57 datë 02.06.2016 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 52.

### **Raporti i detyrimeve të prapambetura.**

Nga auditimi konstatohet se KLP nuk ka përgatitur dhe raportuar detyrime të prapambetura në MFE për vitin 2021. Nga auditimi i dokumenteve dhe nga kryqëzimi i të dhënave me thesarin konstatohen tri fatura të pa likuiduara gjatë vitit 2021 të cilat rezultojnë të papaguara mbi 60 ditë vonesë nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik (lindjes së detyrimit financiar) të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme. Konstatohet se këto detyrime financiare që rezultojnë të papaguara në fund të vitit 2021 nuk janë raportuar si detyrim i prapambetur për vitin 2021 për efekt balanca e detyrimeve të papaguara nuk paraqet pasqyrim real në degën e thesarit, në kundërshtim me Udhëzimin Nr.37, datë 06.10.2020 “*Monitorimi dhe publikimi periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”, kreu II dhe kreu III, pika 1 dhe në kundërshtim me Udhëzimin Nr.9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” pika 186 ku citohet “*..Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, që për mungesë fondesh buxhetore apo faktorë të tjerë, kanë detyrime të pa likuiduara dhe presin për t’u paguar në periudha të ardhshme, duhet të kryejnë regjistrimin dhe evidentimin në kontabilitet dhe në SIFQ të këtyre detyrimeve të prapambetura (për këtë qëllim do të shërbejë manuali përkatës i procedurës së regjistrimit dhe evidentimit në kontabilitet dhe në SIFQ)...*”. Konstatohet se këto fatura janë likuiduara në muajin qershor të vitit 2022 afërsisht 260 ditë vonesë.

Tabela 4. Faturat e papaguara për vitin 2021 (në lekë)

<b>Përshkrimi</b>	<b>Furnitori</b>	<b>Shuma</b>	<b>Data furnitorit</b>	<b>Data urdhër shpenzimit</b>	<b>Vonesa</b>
Shërbime te sigurimit dhe ruajtjes	Ndërmarrja industriale Nr 1	7,395	9/30/2021	6/17/2022	-260
Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	Ndërmarrja industriale Nr 1	549,148	10/1/2021	6/17/2022	-259
Ujë	Ndërmarrja industriale Nr 1	78,826	10/1/2021	6/17/2022	-259
	<b>Totali</b>	<b>635,369</b>			

*Burimi: të dhënat nga thesari, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së*

### **Buxheti i Vitit 2022**

#### *Përgatitja e PBA 2022-2024*

Gjatë vitit 2021 grupi i GMS-ës dhe grupi i EMP-ës kanë funksionuar në zbatim të Urdhrit Nr.61 datë 26.06.2020 “Për ngritjen e grupit GMS” dhe Urdhrit Nr.62 datë 26.06.2020 “Për ngritjen e grupit EMP”. Gjatë vitit 2021 grupi i GMS-së dhe EMP-së janë mbledhur dy herë për të hartuar

kërkesat buxhetore PBA 2022-2023 në respektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në Udhëzimin Nr.23, datë 22.11.2016 “*Procedurat standarde të përgatitjes së Programit buxhetor afatmesëm*”. Me shkresën Nr. 755/1 Prot, datë 01.05.2021, KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2022-2024 faza e parë, strategjike. Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2022, ka planifikuar kërkesat buxhetore vetëm për një program 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë i Prokurorisë. Janë planifikuar fondet për shpenzime personeli në vlerën 119,917 mijë lekë sipas strukturës ekzistuese me 65 punonjës. Shpenzimet operative janë planifikuar në vlerën 30,883 mijë lekë. Shpenzimet kapitale në vlerën 8,000 mijë leke, për të blerë 2 makina në vlerën 7,000 mijë lekë dhe 1,000 mijë lekë janë planifikuar për tu shpenzuar për ndarjen funksionale të zyrave. Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të tavaneve të miratuara me VKM Nr.190 datë 03.03.2021 "Për miratimin e tavane përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2024" në nivel programi. Me shkresën Nr. 1957/1 Prot, datë 01.09.2021, KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2022-2024, faza e dytë. Kërkesat buxhetore në fazën e dytë të PBA-së nuk kanë ndryshime. Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të tavaneve të miratuara me VKM Nr.440 datë 22.07.2021 "Për miratimin e tavane përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2024" në nivel programi.

Tabela 5. Pasqyra e kërkesave buxhetore PBA 2022-2024 (në mijë lekë)

Emërtimi	Viti buxhetor 2022		Viti buxhetor 2023		Viti buxhetor 2024	
	Kërkesa buxhetore	Tavani	Kërkesa buxhetore	Tavani	Kërkesa buxhetore	Tavani
Shpenz. Korrente	150,800	150,800	154,960	154,960	160,175	160,175
Shpenz. Kapitale	8,000	8,000	10,000	10,000	10,000	10,000
<b>Totali</b>	<b>158,800</b>	<b>158,800</b>	<b>164,960</b>	<b>164,960</b>	<b>170,175</b>	<b>170,175</b>

Burimi: KLP , përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Me Ligjin Nr.115/2021, datë 16.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë i Prokurorisë” për programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në vlerën totale 158,800 mijë lekë. Me shkresën Nr. 22922/150 Prot, datë 18.01.2022, Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka dërguar detajimin e shpenzimeve korente për vitet 2022-2024 me vlerë totale 150,800 mijë lekë. Me shkresën Nr. 22922/201 Prot, datë 07.02.2022 MFE ka dërguar detajimin e buxhetit për shpenzimet kapitale në vlerën 8,000 mijë lekë.

#### Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2022

Gjatë vitit 2022, buxheti i KLP-së është rishikuar si më poshtë:

-KLP ka dërguar pranë MFE-së me shkresën Nr.130 Prot, datë 28.01.2022 “Kërkesë për transferim fondi” nga llogaria 602 në llogarinë 606 vlera 300 mijë lekë me qëllim kryerjen e pagesës për kompensimin e funksionarëve përfitues të telefonisë celulare sipas pikës 14, të VKM 673/2020. Me shkresën Nr.1700/1 Prot, datë 09.02.2022, MFE miraton transferimin e fondeve sipas kërkesës së KLP-së.

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr.3802 Prot, datë 28.02.2022 dërgon detajimin e fondit të veçantë për vitin 2022 në vlerën 150 mijë lekë.

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr. 4934/84 Prot, datë 04.04.2022, ka përcjellë pakësimin e fondit për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, mbështetur në Aktin

Normativ Nr.3, datë 12.03.2022, në vlerën totale 9,174 mijë lekë. Nga të cilat pakësohet llog. 600 me 2,666 mijë lekë 397 mijë lekë , pakësohet llog. 601 me 331 mijë lekë dhe pakësohet llog. 602 me 6,176 mijë lekë.

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr 156/1 Prot, datë 11.01.2023, ka përcjellë shtimin e fondit në llogarinë 606 në vlerën 770 mijë lekë për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, mbështetur në VKM Nr. 898, datë 29.12.2022.

-Me shkresën Nr. 18479/1 Prot, datë 19.10.2022 MFE ka miratuar transferimin e fondit për llogarinë 600 pakësim në vlerën 1,000 mijë lekë dhe shtim fondi në llogarinë 602 në vlerën 1,000 mijë lekë për të mbuluar shpenzimet operative.

Tabela 6. Buxheti vjetor i rishikuar (në mijë lekë)

Art.	Emërtimi	PBA		Buxheti Vjetor 2022	Buxheti Vjetor 2022
		Plan	Viti 2022 <sup>2</sup>	Plan Fillestar me ligjin e buxhetit të vitit 2022	Buxheti i rishikuar
600	Paga		106,676	106,676	103,010
601	Sigurime Shoqërore		13,241	13,241	12,910
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		30,888	30,888	25,412
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ		0	0	1,220
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Korrente</i>		150,800	150,800	142,552
231	Kapitale të Trupëzuara		8,000	8,000	8,000
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale</i>		8,000	8,000	8,000
<b>Totali</b>			<b>158,800</b>	<b>158,800</b>	<b>150,552</b>

Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Konstatohet se kërkesat për rishpërndarje fondi i plotësojnë të gjitha kriteret formale të përcaktuara në Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” , neni 44 dhe Udhëzimin Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat për zbatimin e buxhetit”, kreu “Rishpërndarje fondi”.

#### Mbi realizimin e planit të buxhetit të vitit 2022

Buxheti i vitit 2022 i alokuar me Ligjin Nr. 115/2021, datë 16.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” për Këshillin e Lartë të Prokurorisë në fillim të vitit 2022, ishte 158,800 mijë lekë. Me ndryshimet e pësuara gjatë vitit ky buxhet është në vlerën 150,552 mijë lekë.

Tabela 7. Shpenzimet buxhetore të vitit 2022 sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

Art.	Emërtimi	PBA		Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	%
		Plan Viti 2022	Plan Fillestar Viti 2022	I rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimit	
600	Paga	106,676	106,676	103,010	102,730	99%	
601	Sigurime shoqërore	13,241	13,241	12,910	12,898	100%	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	30,888	30,888	25,412	25,284	100%	
606	Trans. Për Buxh. Fam. dhe Ind.	0	0	1,220	1,073	88%	
	Shpenzime Korrente	150,800	150,800	142,552	141,985	99%	
231	Kapitale të Trupëzuara	8,000	8,000	8,000	7,834	98%	
	Shpenzime Kapitale	8,000	8,000	8,000	7,834	98%	
	<b>Totali</b>	<b>158,800</b>	<b>158,800</b>	<b>150,552</b>	<b>149,821</b>	<b>99%</b>	

Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Realizimi faktik për vitin 2022 është 149,821 mijë lekë, ose në masën 99% e total buxhetit të planifikuar.

<sup>2</sup> Vlerat e vendosura në kolonën “PBA viti 2022” janë vlerat sipas kërkesave buxhetore në PBA 2022-2024, faza e dyte.

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“Artikulli 600 + 601” - Buxheti vjetor i alokuar në *shpenzime personeli* për këtë program është 115,920 mijë lekë ose 76 % të total buxhetit të planifikuar. Realizimi faktik është 115,628 mijë lekë ose në masën 99 % (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”* për është 25,412 mijë lekë ose 17 % të total buxhetit. Realizimi vjetor i fondeve buxhetore në shpenzime operative është 25,284 mijë lekë ose në masën 100 %. Këto fonde janë përdorur në funksion të aktivitetit të KLP-së kryesisht për të mbuluar shërbimet e kryera nga Ndërmarrja Industriale Nr.1 që zënë afërsisht 50% të total llogarisë 602. Pjesa tjetër e fondeve përdoret për blerjen e materiale dhe shërbimeve në zyrë, shpenzime transporti, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme etj.

Masa e realizimit të shpenzimeve korrente 99 % e total buxhetit të planifikuar, tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet të fondeve buxhetore.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”* për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2022, është 1,220 mijëlekë. Fondi u planifikua për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për funksionarët përfitues. Gjatë vitit është përdorur fondi në vlerën 1,073 mijë lekë ose në masën 88 %.

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program është planifikuar 8,000 mijë lekë për realizimin e dy projekteve, me kod “18CK801” blerjen e dy automjeteve për anëtarët e KLP dhe projekti me kod “20AA104” për ndarjen funksionale të zyrave. Realizimi faktik në artikullin 231 në total për këtë program është 7,834 mijë lekë, ose në masën 99% të tij, i detajuar sipas projekteve, projekti “18CK801” blerje automjeti, realizuar në masën 99%, dhe projekti “20AA104” për ndarjen funksionale të zyrave realizuar në masën 88%. (të rakorduar edhe me sistemin SIFQ).

Konstatohet se angazhimet buxhetorë të ndërmarrja gjatë vitit 2022 janë në përputhje me përcaktimet e Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50-52, dhe UMFE Nr. 9 datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kreu “E drejta për të kryer shpenzime”, neni 79-83.

### **Verifikimi i respektimit të afateve të likuidimit të faturave.**

Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231). Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se gjatë vitit 2022 janë kryer afërsisht 230 transaksione. Nga verifikimi rezulton se gjatë vitit 2022 janë likuiduar rezultojnë 17 raste ose 7 % e total transaksioneve janë likuiduar përtej afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik. Nga këto, 3 raste në shumën 635,369 lekë të cilat i përkasin si datë fature vitit 2021, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2022 për t'u likuiduar dhe 14 rastet e tjera janë obligime të krijuara gjatë vitit 2022. Fatura e papaguara të vitit 2021 i përkasin një operatori ekonomik, “Ndërmarrja industriale Nr 1” për shërbim pastrimi dhe gjelbërimi, shërbim të sigurimit dhe ruajtjes dhe për ujë. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9 datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 si dhe në Ligjin Nr. 57 datë 02.06.2016 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 52. Nga auditimi

i dokumenteve vlen të theksohet bazuar edhe në shkresën Nr.2354 Prot, datë 30.11.2022 “Kërkesë për fonde buxhetore” dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën në testim e gjithë popullata për llogari të buxhetit të vitit 2022, me një total prej 230 transaksione që përfshijnë një vlerë transaksionesh prej 33 milion lekë. Konstatohet se në 30 raste nuk është respektuar rregullit FIFO në likuidimin e faturave, duke rritur riskun potencial për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi konstatohet se për këto raste të evidentuara në tabelën e mëposhtme janë procesuar transaksione në datat e ndërmjetme të datës së regjistrimit të transaksioneve në sistem dhe datës së ekzekutimit në sistem, çka përcakton devijimin në parimin hyrje e parë, dalje e parë sipas përcaktimeve në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit.

*Informacioni i hollësishëm mbi faturat e likuiduara përtej afatit 30 ditor dhe faturave të likuiduara jo në respektim të rregullit FIFO gjenden në Aneksin Nr.1, pjesë e këtij raporti.*

Nga auditimi konstatohet se KLP nuk ka detyrime të prapambetura për vitin 2022.

### **Buxheti i vitit 2023**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vitin 2023 administron dhe menaxhon fondet nga buxheti i shtetit dhe nuk kanë të ardhura të tjera. Gjatë vitit 2023 KLP ka funksionuar me strukturën organizative të ndryshuar, miratuar me Vendimin Nr. 183, datë 24.04.2023 ”Për një ndryshim në vendimin Nr. 73, datë 24.04.2023 “Për miratimin e strukturës së administratës së Këshillit të lartë të Prokurorisë”, me 72 punonjës.

### **Përgatitja e PBA 2023-2025**

Anëtarët e Ekipeve të Menaxhimit të Programit dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar kërkesat buxhetore të PBA 2023-2025 në respektim të Udhëzimit Nr. 9 datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, KLP në mbledhjen plenare datë 09.05.2022 me Vendimin Nr. 96, ka miratuar relacionin e Komisionit të Buxhetit mbi kërkesat PBA 2023-2025. Me shkresën Nr. 549/1 Prot, datë 06.05.2022 KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2023-2025 faza e parë, strategjike. Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2023, ka planifikuar kërkesat buxhetore vetëm për një program 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë i Prokurorisë. Buxheti i planifikuar për vitin 2023 është në vlerën 200,936 mijë lekë, përfshirë edhe kërkesat shtesë për financim të politikave të reja. Janë planifikuar fondet për shpenzime personeli në vlerën 137,937 mijë lekë bazuar në planifikimin për të ndryshuar strukturën organizative nga 65 punonjës në 78 punonjës. Shpenzimet operative janë planifikuar në vlerën 35,000 mijë lekë për të mbuluar shpenzimet për mjete kancelarie, mirëmbajtje dhe shpenzimet logjistike sipas kontratës me Ndërmarrjen Industriale Nr.1.

Shpenzimet kapitale janë planifikuar në vlerën 28,000 mije lekë, për realizimin e pesë projekteve. Konkretisht:

- Projekti “20AA104” Rikonstruksion dhe ndërtim zyrash në vlerën 5,000 mijë lekë,
- Projekti “18CK801” Blerje automjete në vlerën 5,000 mijë lekë,
- Projekti “18CK901” Pajisje informatike në vlerën 10,500 mijë lekë,
- Projekti “19AA5” Arkiv digjital në vlerën 2,500 mijë lekë,
- Pajisje zyrash mobilje në vlerën 5,000 mijë lekë.



Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të tavaneve të miratuara me VKM Nr.130 datë 02.03.2022 "Për miratimin e tavane përgatitore të shpenzimeve për PBA 2023-2025" në nivel programi.

Me shkresën Nr. 1874/1 Prot, datë 30.08.2022, KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2023-2025, faza e dytë. Kërkesat buxhetore në fazën e dytë të PBA-së kanë pësuar ndryshime në respektim të tavaneve të miratuara me një diferencë me pak në vlerën 45,932 mijë lekë. Nga ky pakësim buxheti janë prekur shpenzimet korente duke u pakësuar në vlerën 27,937 mijë lekë. Ndryshim ka pësuar edhe shpenzimet kapitale duke u zvogëluar në vlerën 10,000 mijë lekë, ku janë planifikuar të realizohen vetëm dy projekte investimi, Projekti "20AA104" Rikonstruksion dhe ndërtim zyrash në vlerën 5,000 mijë lekë dhe Projekti "18CK801" Blerje automjete në vlerën 5,000 mijë lekë.

Buxheti i planifikuar PBA 2023-2025 i detajuar është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8. Kërkesat buxhetore PBA 2023-2025, faza e dytë (në mijë lekë)

Artikujt	Buxheti	PBA 2023-2025		
	2022	2023	2024	2025
Paga(600-601)	116,919	119,917	119,917	119,917
Korente të tjera (602-606)	24,406	25,083	27,083	29,083
Kapitale (230-232)	8,000	10,000	10,000	10,000
<b>Totali</b>	<b>149,325</b>	<b>155,000</b>	<b>157,000</b>	<b>159,000</b>

Burimi:KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Konstatohet se kërkesat buxhetore fazë e dytë janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të tavaneve të miratuara me VKM Nr.535 datë 29.07.2022 "Për miratimin e tavane përgatitore të shpenzimeve për PBA 2023-2025" në nivel programi.

Në zbatim të Ligjit Nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" dhe shkresës dërguar nga MFE shkresa Nr. 2285 Prot, datë 13.12.2022 "Mbi përditësimin e të dhënave në AFMIS për fazën e tretë të PBA 2023-2025", KLP ka dërguar kërkesat buxhetore faza e tretë. Konkretisht e detajuar në tabelën e mëposhtme". Me ndryshimet në buxhetin e vitit 2023, janë planifikuar të realizohen 4 projekte investimi:

- Projekti "20AA104" Rikonstruksion dhe ndërtim zyrash në vlerën 4,000 mijë lekë,
- Projekti "18CK801" Blerje automjete në vlerën 5,000 mijë lekë,
- Projekti "18CK901" Pajisje informatike në vlerën 5,000 mijë lekë,
- Pajisje zyrash kasaforta në vlerën 1,000 mijë lekë.

Tabela 9. Kërkesat buxhetore PBA 2023-2025, faza e tretë (në mijë lekë)

Artikujt	Buxheti	PBA 2023-2025		
	2022	2023	2024	2025
Paga(600-601)	116,919	132,517	132,517	132,517
Korente të tjera (602-606)	24,406	25,083	21,483	21,483
Kapitale (230-232)	8,000	15,000	10,000	10,000
<b>Totali</b>	<b>149,325</b>	<b>172,600</b>	<b>164,000</b>	<b>164,000</b>

Burimi:KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Konstatohet se kërkesat buxhetore, fazë e tretë janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të tavaneve të miratuara me Ligjin Nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 202" në nivel programi.

Me Ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor për vitin 2023, janë miratuar për një program të vetëm buxhetor;

Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, në vlerën 172,600 mijë lekë ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Fondet buxhetore për shpenzime personeli janë planifikuar sipas strukturës së re organike me 72 punonjës.

Tabela 10. Buxheti i vitit 2023 sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

Art.	Emërtimi	PBA		Buxheti Vjetor
		Plan	Viti 2023 <sup>3</sup>	Plan Fillestar me ligjin e buxhetit të vitit 2022
600	Paga		117,076	117,076
601	Sigurime Shoqërore		15,441	15,441
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		25,083	25,083
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ		0	0
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Korrente</i>		157,600	157,600
231	Kapitale të Trupëzuara		15,000	15,000
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale</i>		15,000	15,000
<b>Totali</b>			<b>172,600</b>	<b>172,600</b>

Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

### Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar si më poshtë:

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues Nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor Këshillin e Lartë i Prokurorisë në shumën 150,000 lekë.

-Me shkresën Nr. 11623/1 Prot, datë 03.07.2023 MFE ka dërguar akordimin e fondeve shtesë për rritjen e pagave në zbatim të Ligjit 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, VKM Nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabinetëve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës”, VKM Nr.326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, KLP me shkresën nr. 1388/1 Prot, datë 23.06.2023. Shtohet llogaria ekonomik 600 me vlerën 12,500 mijë lekë dhe llogaria ekonomike 601 shtohet me vlerën 1,500 mijë lekë.

-Me shkresën Nr.12396/1 Prot, datë 13.07.2023, MFE ka miratuar transferimin e fondeve të kërkuar nga KLP sipas relacionit shoqëruar, pakësim të llogarisë 602 në vlerën 948 mijë lekë dhe shtim të llogarisë 606 në vlerën 948 mijë lekë.

- Me shkresën Nr. 16478/3 Prot, datë 09.10.2023, MFE ka miratuar transferimin e fondeve të kërkuar nga KLP sipas relacionit shpjegues, me qëllim mbulimin e shpenzimeve operative, pakësim të llogarisë 600+601 në vlerën 3,000 mijë lekë dhe shtim të llogarisë 602 në vlerën 3,000 mijë lekë.

- Me shkresën Nr. 18622/1 Prot, datë 24.10.2023, MFE ka miratuar rialokimin e fondit për investime të kërkuar nga KLP sipas relacionit shpjegues, me qëllim blerjen e raftëve metalik.

<sup>3</sup> Vlerat e vendosura në kolonën “PBA viti 2023” janë vlerat sipas kërkesave buxhetore në PBA 2023-2025, faza e tretë.

- Në zbatim të AN Nr.6, datë 14.12.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar edhe shtimi i llogarisë 602 në vlerën 3,000 mijë lekë.

- Me shkresën Nr. 22794/1 Prot, datë 29.12.2023, MFE ka miratuar akordimin e fondit për pagesë pas ndërprerjes së funksionit të fundit në vlerën 2,198,000 lekë në llogarinë 606, të kërkuar nga KLP për tre anëtarët e larguar.

-Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.755, datë 20.12.2023 është akorduar fondi shtesë në zërin shpenzime korrente për pagesën e një pjesë të diferencës së pagesës së magjistratit sipas arsytimit të Vendimit Nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis, në kuadër të procesit të negociatave me BE” dhe shkresës Nr. 57/6 Prot, datë 08.01.2024 akordohen fondi për shpërblimin e dy punonjësve të KLP në vlerën 637 mijë lekë në buxhetin e vitit 2023.

Konstatohet se kërkesat për rishpërndarje fondi i plotësojnë të gjitha kriteret formale të përcaktuara në Udhëzimin Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat për zbatimin e buxhetit”, kreu “Rishpërndarje fondi”.

### Mbi realizimin e planit të buxhetit të vitit 2023

Buxheti i vitit 2023 i alokuar me Ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë në fillim të vitit 2023, ishte 172,600 mijë lekë. Me ndryshimet e pësuara gjatë vitit ky buxhet është në vlerën 202,585 mijë lekë ose 29,984 mijë lekë më shumë nga buxheti fillestar. Peshën më të madhe në këtë rritje e zënë shpenzimet korrente, kryesisht artikulli 600 që zë 70% të rritjes së buxhetit për shkak të ndryshimeve ligjore në llogaritjen e pagës.

Tabela 11. Shpenzimet buxhetore të vitit 2023 sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

Art.	Emërtimi	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	%
		Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	I rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimit
600	Paga	117,076	117,076	138,213	138,208	100%
601	Sigurime shoqërore	15,441	15,441	15,941	15,632	98%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	25,083	25,083	30,134	29,978	99%
606	Trans. Për Buxh. Fam. dhe Ind.	0	0	3,296	3,175	96%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	<b>157,600</b>	<b>157,600</b>	<b>187,584</b>	<b>186,993</b>	<b>100%</b>
231	Kapitale të Trupëzuara	15,000	15,000	15,000	13,923	93%
	Shpenzime Kapitale	15,000	15,000	15,000	13,923	93%
	<b>Totali</b>	<b>172,600</b>	<b>172,600</b>	<b>202,585</b>	<b>200,916</b>	<b>99%</b>

Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Realizimi faktik për vitin 2023 është 202,585 mijë lekë, ose në masën 99% e total buxhetit të planifikuar.

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“Artikulli 600 + 601” - Buxheti vjetor i alokuar në *shpenzime personeli* për këtë program është 154,154 mijë lekë ose 76 % të total buxhetit të planifikuar. Realizimi faktik është 153,840 mijë lekë ose në masën 99 % (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për është 30,134 mijë lekë ose 15 % të total buxhetit. Realizimi vjetor i fondeve buxhetore në shpenzime operative është 29,978 mijë lekë ose në masën 99 %. Këto fonde janë përdorur në funksion të aktivitetit të KLP-së kryesisht për të mbuluar shërbimet e kryera nga Ndërmarrja Industriale Nr.1 që zënë afërsisht 50% të total fondeve në llogarinë 602. Pjesa tjetër e fondeve

përdoret për blerjen e materiale dhe shërbimeve në zyre, shpenzime transporti, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme etj.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2023 është 3,296 mijë lekë. Fondi u planifikua për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për funksionarët përfitues. Gjatë vitit është përdorur fondi në vlerën 3,175 mijë lekë ose në masën 88 % e total fondit të planifikuar në Llog.606. Masa e realizimit të shpenzimeve korrente 100 % e total buxhetit të planifikuar, tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet të fondeve buxhetore.

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program është planifikuar 15,000 mijë lekë për realizimin e katër projekteve. Realizimi faktik në artikullin 231 në total për këtë program është 13,923 mijë lekë, ose në masën 93 % të tij (të rakorduar edhe me sistemin SIFQ).

- Projekti “20AA104” Rikonstruksion dhe ndërtim zyrash” planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë, është realizuar në masën 96 % të fondit të planifikuar.

- Projekti “18CK801” Blerje automjete planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë, është realizuar në masën 90% të fondit të planifikuar.

- Projekti “18CK901” Pajisje informatike planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë, është realizuar në masën 92 % e fondit të planifikuar.

Konstatohet se angazhimet buxhetorë të ndërmarra gjatë vitit 2023 janë në përputhje me përcaktimet e Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50-52, dhe UMFE Nr.9 datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kreu “E drejta për të kryer shpenzime”, nenit 79-83.

### **Verifikimi i respektimit të afateve të likuidimit të faturave gjatë vitit 2023.**

Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231). Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se gjatë vitit 2023 janë kryer afërsisht 256 transaksione në vlerën 43 milion lekë. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se gjatë vitit 2023 janë likuiduar 2 raste në shumën 597,517 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2022, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2023 për t’u likuiduar. Këto fatura i përkasin një operatori ekonomik, “Ndërmarrja industriale Nr 1” shërbim të sigurimit dhe ruajtjes dhe për ujë. Gjithashtu referuar të dhënave të marra nga sistemi SIFQ rezultojnë 3 raste në vlerën 355,252 lekë të likuiduara përtej afatit 30 ditor të përcaktuar në Udhëzimin Nr.9 datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 si dhe në Ligjin Nr.57, datë 02.06.2016 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 52. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penalteteve. Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u konstatuan se në 20 raste nuk është respektuar rregullit FIFO në likuidimin e faturave, duke rritur riskun potencial për krijimin e detyrimeve të prapambetura në kundërshtim me Udhëzimin Nr.9, datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kreu III “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve”, pika 151. Nga auditimi konstatohet se për këto raste të evidentuara në tabelën e mësipërme janë procesuar transaksione në datat e ndërmjetme të datës së regjistrimit të transaksioneve në sistem dhe datës së ekzekutimit në sistem, çka përcakton devijimin në parimin hyrje e parë, dalje e parë sipas përcaktimeve në udhëzimin

standard të zbatimit të buxhetit. Informacioni i hollësishëm mbi faturat e likuiduara përtej afatit 30 ditor dhe jo në respektim të rregullit FIFO gjenden në Aneksin nr.2.

Nga auditimi konstatohet se KLP nuk ka detyrime të prapambetura për vitin 2023.

#### Përgatitja e PBA 2024-2026

Anëtarët e Ekipeve të Menaxhimit të Programit dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar kërkesat buxhetore të PBA 2024-2026 në respektim të Udhëzimit Nr. 5, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”. KLP, në mbledhjen plenare datë 02.05.2023 me Vendimin Nr.90 ka miratuar relacionin e Komisionit të Buxhetit mbi kërkesat buxhetore për fazën strategjike PBA 2024-2026. Me shkresën Nr.985/1 Prot, datë 08.05.2023, KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2024-2026 faza e parë, strategjike. Kërkesat buxhetore të KLP-së janë paraqitur vetëm për një program buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në vlerën 189,407 mijë lekë. Në respektim të Udhëzimit plotësues Nr.22, datë 07.07.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, faza e dytë teknike, grupi i GMS-ës dhe grupi i EMP-ës kanë miratuar kërkesat buxhetore sipas tavaneve të miratuara dhe kërkesat buxhetore që kanë nevojë për financim shtesë. Buxheti i planifikuar për vitin 2024 është në vlerën 218,678 mijë lekë. Me shkresën Nr.4558 datë, 28.08.2023 KLP ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda afatit dokumentin e kërkesave buxhetore, 2024-2026, faza e dytë teknike.

Tabela 12. Pasqyra e kërkesave buxhetore PBA 2024-2026 (në mijë lekë)

Emërtimi	Buxheti 2023	PBA 2024-2026		
		Kërkesa buxhetore 2024	Kërkesa buxhetore 2025	Kërkesa buxhetore 2026
Paga (600-601)	132,517	173,678	173,678	173,678
Korente të tjera( 602-606)	25,083	35,000	35,000	35,000
Kapitale(230-231)	15,000	10,000	10,000	10,000
<b>Totali</b>	<b>172,600</b>	<b>218,678</b>	<b>218,678</b>	<b>218,678</b>

Burimi: KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

#### **Mbi raportin e monitorimit**

Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion mbi zbatimin e procedurës dhe afatet që duhet ndjekur nga KLP gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare dhe jo-financiare me qëllim realizimin e objektivave të synuara si edhe përgatitja e tre raporteve periodike të monitorimit në vit mbi performancën e produkteve konstatohet se ;

Për vitin 2021 janë dorëzuar pranë MFE raportet :

Raporti 4- mujor dërguar me shkresën Nr.911/1 Prot, datë 01.05.2021.

Raporti 12 mujor dërguar me shkresën Nr. 687/1 Prot, datë 30.03.2022.

Për vitin 2023 janë dorëzuar raportet :

Raporti 8-mujor dërguar me shkresën Nr. 2293 Prot, datë 03.10.2023.

Tabela 13. Raportet e monitorimit

Raporti i monitorimit	4-mujor	8-mujor	12-mujor
2021	✓	-	✓
2022	-	-	-
2023	-	✓	-

Burimi:KLP, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Nga auditimi i dokumenteve konstatohet se KLP nuk ka dorëzuar raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi 2021-2023 pranë MFE sipas përcaktime ligjore, pasi nga ky informacion mbi performancën financiare të buxhetit, MFE bën propozimin për ri-alokimin e burimeve dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore. Konstatohet se për vitin 2021 nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 8-mujor. Për vitin 2022 rezulton se nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 4-mujor, 8-mujor dhe raporti 12-mujor. Për vitin 2023 nuk është dorëzuar raporti 4-mujor dhe raporti 12 mujor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 65 “Monitorimi” ku citohet “.. Nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm” dhe në kundërshtim me Udhëzimin Nr.22, datë 17.11.20216 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ku citohet “Raportet e 4-mujorit dhe 8-mujorit duhet të dorëzohen pranë MFE deri me 30 Maj dhe me 30 Shtator, ndërsa raporti 12-mujor duhet të dorëzohet deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës”

### **Gjetja 1: Tejkallim i afateve për kryerjen e pagesave dhe mos respektim i parimit FIFO.**

**Situata:** Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të pagesave të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkallime të afateve të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, nga ana e njësisë shpenzuese. Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave si edhe respektimit të rregullit FIFO, për periudhën objekt auditimi janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231). Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga thesari rezultojnë se për vitin 2022 dhe vitin 2023 janë 20 raste ose 4 % e total transaksioneve të likuiduara jashtë afatit 30 ditorë dhe 50 raste ose 10% e total transaksioneve të likuiduara jo në respektim të rregullit hyrje e pare dalje e pare. - gjatë vitit 2022 janë kryer afërsisht 230 transaksione nga këto konstatohet se 17 raste ose 7 % e total transaksioneve janë likuiduar përtej afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik. Nga këto rezultojnë 3 raste në shumën 635,369 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2021, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2022 për t’u likuiduar. Këto fatura i përkasin një operatori ekonomik, “Ndërmarrja industriale Nr 1” për shërbim pastrimi dhe gjelbërimi, shërbim të sigurimit dhe ruajtjes dhe për ujë. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën në testim e njëjta popullatë, me një total prej 230 transaksione që përfshijnë një vlerë transaksionesh prej 33 milion lekë. Konstatohet se në 30 raste ose 13 % e total transaksioneve nuk është respektuar rregullit FIFO në likuidimin e faturave, duke rritur riskun potencial për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi konstatohet se për këto raste të evidentuara janë procesuar transaksione në datat e ndërmjetme të datës së regjistrimit të transaksioneve në sistem dhe datës së ekzekutimit në sistem, çka përcakton devijimin në parimin hyrje e parë, dalje e parë sipas përcaktimeve në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit.

- gjatë vitit 2023 janë kryer afërsisht 256 transaksione në vlerën 43 milion lekë. Referuar të dhënave të marra nga sistemi SIFQ rezultojnë 5 raste në vlerën 952,769 lekë të likuiduara përtej afatit 30 ditor. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se janë likuiduar 2 raste në shumën 597,517 lekë të cilat i përkasin si datë fature vitit 2022, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2023 për t'u likuiduar dhe 3 raste në vlerën 355,252 lekë i përkasin vitit 2023. Faturat e vitit 2022 i përkasin një operatori ekonomik, "Ndërmarrja industriale Nr 1" shërbim të sigurimit dhe ruajtjes dhe për ujë. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve. Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u konstatuan se në 20 raste nuk është respektuar rregullit FIFO në likuidimin e faturave, duke rritur riskun potencial për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Kriteri:** Ligji Nr. 57 datë 02.06.2016 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*", neni 52, i ndryshuar; Udhëzimin Nr. 9 datë 20.303.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika 184 dhe pika 180 "*Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.*"; Udhëzimin Nr. 9 datë 20.303.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", kreu III "*Procedurat për kryerjen e shpenzimeve*";

Ligjit Nr. 48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*", nenin 7.

**Shkaku:** Mos detajimi i planit buxhetor në kohën dhe vlerën e duhur si edhe mos ndjekja e radhës së pagesave.

**Efekti:** Ekspozojnë buxhetin e KLP-së ndaj riskut të detyrimeve shtesë financiare si pasojë e penaliteteve për mos shlyerjen e detyrimeve financiare në kohë.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të merren masa për sigurimin e likuiditetit të mjaftueshëm me qëllim financimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore dhe ekzekutimit të tyre në procesimin normal të ciklit të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore duke respektuar afatet, radhën dhe prioritet e pagesave buxhetore.

## **Gjetja 2: Mos dërgim i Raportit të Monitorimit pranë Ministrisë së Financës**

**Situata:** Nga auditimi i dokumenteve mbi zbatimin e procedurave dhe afateve për monitorimin dhe zbatimin e buxhetit për performancën financiare mbi realizimin e programit buxhetor konstatohet se KLP nuk ka dorëzuar raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi 2021-2023 sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.22, datë 17.11.2016 "*Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*". Konstatohet se KLP nuk ka përgatitur dhe dorëzuar raporti 8-mujor për vitin 2021. Për vitin 2022 rezulton se nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 4-mujor, 8-mujor dhe raporti 12-mujor. Për vitin 2023 nuk është dorëzuar raporti 4-mujor dhe raporti 12 mujor. Nga këto raporte gjenerohet informacion mbi performancën financiare që i nevojitet MFE për të propozuar ri-alokimin e burimeve dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore

**Kriteri:** Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*", i ndryshuar, neni 65 "*Monitorimi*";

Udhëzimi Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ku citohet “Raportet e 4-mujorit dhe 8-mujorit duhet të dorëzohen pranë MFE deri me 30 Maj dhe me 30 Shtator, ndërsa raporti 12-mujor duhet të dorëzohet deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës”.

**Shkaku:** Mos zbatim i legjislacionit

**Efekti:** Ministria e Financës nuk ka të dhënat e plota dhe të sakta për të propozuar ri-alokimin e burimeve dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për përgatitjen e informacionit mbi performancën financiare dhe dërgimin e raportit të monitorimit sipas afateve me qëllim që MF të ketë të dhënat e plota për të bërë propozimin për ri-alokimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore gjatë vitit.

### **2.3 Mbi auditimin e llogarive vjetore**

Në zbatim të pikës II/3 “*Auditimi i llogarive vjetore*”, të programit të auditimit Nr. 104/1, datë 29.01.2024”, ku përfshihen çështjet e mëposhtme:

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

-Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

-Opinionimi mbi pasqyrat financiare të vitit 2022

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Pasqyrat financiare të vitit 2022;

-Libri i madh i llogarive;

-Ditari i Bankës;

-Ditari i Arkës;

-Ditari i shpenzimeve;

-Ditari i magazinës;

-Akt rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë;

-Urdhërat e inventarizimit dhe llogaritë analitike të inventarëve dhe AQT;

-Dokumentacione të tjera justifikues.

Auditimi i drejtimit Nr.3 “*Auditimi i llogarive vjetore*”, u fokusua në **çështjet e mëposhtme:**

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

-Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

-Inventarizimi i pronës Shtetërore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua se:

### **Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (këtu e më poshtë KLP) e ka organizuar kontabilitetin në përputhje me Udhëzimin Nr. 8, datë 09.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Organizimi i kontabilitetit është bërë



sipas metodës së njohjes së të ardhurave dhe shpenzimeve. Kontabiliteti është mbajtur nëpërmjet programit Excel dhe për regjistrimin e të dhënave kronologjike janë përdorur llogaritë, klasat e të cilave janë sipas planit të llogarive të kontabilitetit, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Vlera e paraqitjes së elementëve monetarë është bërë me monedhën funksionale, lekë dhe periudha e raportimit fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

Për vitin 2022, rezultoi se nga KLP pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) Nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE Nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, të përbëra si vijon:

*Tabela Nr.1 “Pasqyrat financiare 2022 të përgatitura nga KLP”*

Formati	Emërtimi i pasqyrës	Paraqitur
Nr.1	Pasqyra e pozicionit financiar;	✓
Nr.2	Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);	✓
Nr.3	Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow), sipas metodës direkte;	✓
Nr.4	Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;	✓
Nr.5	Shënimet shpjeguese;	X
<b>Pasqyrat statistikore:</b>		
Nr.6	Investimet dhe burimet e financimit;	✓
Nr.7/a	Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike);	✓
Nr.7/b	Format Nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto);	✓
Nr.8	Format Nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave .	✓

*Burimi i të dhënave: KLP, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga verifikimi i plotësisë së paraqitjes së informacionit financiar rezultoi se, nga KLP nuk është përgatitur pasqyra e shënimeve shpjeguese (formati Nr. 5), veprim ky në **kundërshtim** me pikën 116 të UMFE Nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar. Pasqyrat financiare janë dërguar pranë Degës së Thesarit Tiranë, me anë të shkresës përcjellëse Nr. 503, datë 15.03.2023, sipas përcaktimeve të pikës të 118 të Udhëzimit të MFE Nr. 8 datë 09.03.2018. Pasqyrat financiare, të vitit ushtrimor 2022 rezultojnë të nënshkruara vetëm nga Sekretari i Përgjithshëm Z. E. Ç, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe jo nga personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë (SIFQ), sipas Degës së Thesarit rezultojnë të kuadruara me pasqyrat e paraqitura nga KLP.

## **I. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.**

### **Pasqyra e Pozicionit Financiar e datës 31.12.2022**

#### **Aktivet:**

#### **I. Aktivet Afatshkurtra**

Në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022 aktivet afatshkurtra paraqiten në vlerën **10,734,531 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 1,302,697 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 9,431,834 lekë.

Në mënyrë të detajuar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela Nr.2 “Aktivet afatshkurtra më 31.12.2022”

Në lekë

8	Ref. e Llog.	E M È R T I M I	2022	2021	Diferenca 22-21
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>48,296,599</b>	<b>51,246,575</b>	<b>(2,949,976)</b>
2		I. Aktivët Afat shkurtër	10,734,531	11,073,593	(339,062)
3		I. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	0	0	0
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>1,302,697</b>	<b>1,972,877</b>	<b>(670,180)</b>
12	31	Materiale	1,142,595	1,831,557	(688,962)
13	32	Inventar i imët	160,102	141,320	18,782
21		<b>3.Llogari të Arkëtueshme</b>	<b>9,431,834</b>	<b>9,100,716</b>	<b>331,118</b>
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	9,431,834	9,100,716	331,118
36		4.Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	0

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”**

Llogaritë e klasës 3, në pasqyrën e pozicionit financiar të KLP përbëhen nga llogaritë kontabël “Materiale” dhe “Inventar i imët”, të cilat në total, në fund të vitit ushtrimor 2022, paraqiten në shumën 1,302,697 lekë.

Diferenca e kësaj klase llogarie me vitin e mëparshëm, përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën **670,180 lekë**, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”.

Për vitin 2022, është kryer inventarizimi i aktiveve afatshkurtra, bazuar në Urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.171, datë 14.12.2022, “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale dhe aktiveve afatshkurtra”, nga i cili ka rezultuar se artikujt kancelarikë (llogaria Nr. 31 “Materiale”) kanë qenë në shumën 1,142,595 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në shumën 160,102 lekë, pra gjendja kontabël për këto klase llogarie përputhet me gjendjen e rezultuar prej inventarizimit fizik.

**Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra”**

Llogaritë e klasës 4 në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqiten në shumën 9,431,834 lekë dhe përbëhen nga llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” e cila krahasuar me një vit më parë është rritur me 331,118 lekë<sup>4</sup>. Kjo llogari paraqitet detyrimin, që shteti i ka Këshillit të Lartë të Prokurorisë në lidhje me shpenzimet e konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por të papaguara ende konkretisht për pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore (të punëdhënësit dhe punëmarrësit), detyrimet për tatimin mbi të ardhurat (TAP), të cilat konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit 2022, por paguhet nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Në mënyrë të detajuar kjo llogari paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr. 3 “Llogaritë analitike të llogarisë 4342”

Në lekë

Llogaritë analitike të llogarisë 4342		9,431,834
42	Detyrime ndaj personelit	6,508,875
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,024,860
435	Sigurime Shoqërore	1,603,376
436	Sigurime Shëndetësore	294,723

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga tabela më sipër rezulton se, shumata e paraqitur në aktiv të Bilancit Kontabël nën zërin “Operacione me shtetin (Të drejta)” është sa shumata aritmetike e llogarive përkatëse (sipas tabelës më sipër) në pasiv të Bilancit Kontabël të datës 31.12.2022, kjo në përputhje me Udhëzimin e MFE

<sup>4</sup> Sipas rreshtit nr. 11 të tabelës nr. 2 “Aktivet afatshkurtra më 31.12.2022”

Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE Nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

## AKTIVET AFATGJATA

### AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

**Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”,** sipas Bilancit Kontabël, të datës 31.12.2022 paraqiten në shumën totale 37,562,068 lekë, ndërsa një vit më parë në shumën 40,172,982 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën 2,610,914 lekë.

Tabela Nr.4: “Klasa e llogarive 21”

Ref. llogarive	EMËRTIMI	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 22-21
21	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>37,562,068</b>	<b>40,172,982</b>	<b>-2,610,914</b>
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	4,694,153	5,777,470	-1,083,317
215	Mjete Transporti	25,707,848	24,888,560	819,288
218	Inventar ekonomik	7,160,067	9,506,952	-2,346,885

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Llogaritë në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

**-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”,** në zërat analitikë të saj përmban: web kamera, kamera me mikrofoni dhe citofon, të cilat në mënyrë të saktë janë klasifikuar në këtë klasë llogarie. Në fund të vitit 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën neto 4,694,153 lekë dhe krahasuar me vitin 2021 rezultojnë 1,083,317 lekë më pak. Nga verifikimi i bërë në lidhje me saktësinë e paraqitjes së vlerës së kësaj llogarie rezultoi se norma e amortizimit e përdorur është 25% në përputhje me pikën me pikën 36 të UMF Nr. 8/2018, ku përcaktohet se: “Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%”;

**-Llogaria 215 “Mjete transporti”,** në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022, paraqitet në vlerën kontabël neto 25,707,848 lekë. Në lidhje me këtë klasë llogarie është mbajtur regjistri i aktiveve në përputhje me pikën 30, të Kreut III, të Udhëzimit të MF Nr. 30, datë 27.12.2011, të ndryshuar.

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”,** në bilancin kontabël të datës 31.12.2022 kjo llogari paraqitet në shumën 7,160,067 lekë dhe krahasuar me një vit më parë është pakësuar me 2,346,885 lekë.

Titulli i gjetjes:	Pasaktësi në paraqitjen e vlerave të AAM-ve”								
<b>Situata:</b>	<p>Nga verifikimi i bërë mbi saktësinë e paraqitjes së vlerës së llogarive të AAM-ve rezultuan pasaktësi të cilat paraqiten si më poshtë:</p> <p><b>-Llogaria 214</b> nuk paraqitet saktë në tepricat fillestare dhe përfundimtare në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022 dhe vlerat në regjistrin e këtyre aktiveve nuk përputhen me ato të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar konkretisht diferencat rezultojnë si në tabelën më poshtë:</p> <p><i>Tabela Nr.5: “Diferencat në paraqitjen e VKN në PF dhe në pasqyrën e amortizimit të tyre”</i> Në lekë</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emërtimi</th> <th>Shuma</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kosto historike 2020</td> <td>8,374,147</td> </tr> <tr> <td>Am 2020</td> <td>2,587</td> </tr> <tr> <td><b>VKN 2020</b></td> <td><b>8,371,560</b></td> </tr> </tbody> </table>	Emërtimi	Shuma	Kosto historike 2020	8,374,147	Am 2020	2,587	<b>VKN 2020</b>	<b>8,371,560</b>
Emërtimi	Shuma								
Kosto historike 2020	8,374,147								
Am 2020	2,587								
<b>VKN 2020</b>	<b>8,371,560</b>								

Shtesa 2021	29,012
Am. 2022	2,098,071
VKN 2021	6,302,502
<b>VKN në PF 2021</b>	<b>5,777,470</b>
<b>Diferenca</b>	<b>525,032</b>
AM 2022	1,573,553
VKN 2022	4,728,949
<b>VKN në PF 2022</b>	<b>4,694,153</b>
<b>Diferenca</b>	<b>34,796</b>

*Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

Nga tabela më sipër rezulton se, teprica fillestare e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, paraqitet e mbivlerësuar me 525,032 lekë ndërsa teprica në fund të vitit 2022 paraqitet e mbivlerësuar me 34,796 lekë. Gjithashtu nga krahasimi i regjistrit të kësaj klase llogarie me vlerën në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022 dhe pasqyrave statistikore 7/a dhe 7/b rezultoi se:

- Në regjistrin e aktiveve vlera kontabël neto e llogarisë 214 në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 4,720,659 lekë, ose 26,506 lekë më tepër se vlera e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022;

- Në pasqyrën statistikore 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ (me kosto historike)*”, vlerat në kolonën “*Gjendje në fillim të vitit*” dhe në kolonën “*Pakësime të tjera*” janë paraqitur në mënyrë të pasaktë, konkretisht vlera në kolonën “*Gjendje në fillim të vitit*” është paraqitur në shumën 5,777,470 lekë nga 8,403,160 lekë që duhet të ishte paraqitur, ndërsa kolonat pakësime me kosto historike nuk duhet të ishin plotësuar pasi gjatë vitit nuk ka pasur pakësime dhe dalje të këtyre aktiveve, për të gjykuar mbi vlerat e tyre historike;

- Në pasqyrën statistikore 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ (Vlera neto)*”, kolona “*Kosto historike*” është paraqitur në shumën 5,777,470 lekë nga 6,302,502 lekë (shumë nga rillogaritjet e vlerave të VKN-së sipas grupit të auditimit të KLSH-së).

**-Llogaria 215 “Mjete transporti”**, rezultoi se nuk është paraqitur saktë në pasqyrën statistikore 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, në mënyrë të detajuar pasaktësitë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Tabela Nr.6: “Pasaktësitë në plotësimin e pasqyrës statistikore Formati 7/b”*

Paraqitja nga:	Në fillim të periudhës			Shtesa		Teprica në fund		
	Kosto historike	Am i akum.	Teprica neto	Kosto historike	Am i akum.	Kosto historike	Am i akum.	Teprica neto
KLP	24,888,560			7,834,600		32,723,160	7,015,312	25,707,848
KLSH	32,682,000	7,793,440	24,888,560	6,956,400		39,638,400	13,930,506	25,707,894
Dif	-7,793,440	-7,793,440	(24,888,560)	878,200	-	(6,915,240)	(6,915,194)	(46)

*Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

- Nga tabela më sipër rezulton se kosto historike e mjeteve të transportit ka qenë sa shuma aritmetike e kostove fillestare e aktiveve të blera para vitit ushtrimor 2022, konkretisht në shumën 32,682,000 lekë, ndërsa vlera sipas paraqitjes së bërë nga KLP është vlera neto, e kësaj llogarie në fund të vitit 2021;

- Shtesat e bëra gjatë vitit 2022 nga ana e KLP-së paraqiten në shumën 7,834,600 lekë, ndërsa sipas regjistrimit të mjeteve të transportit paraqiten si shtesa blerjet e dy makinave me kosto totale 6,956,400 lekë, pra 878,200 lekë më pak;

- Gjithashtu për shkak të pasaktësive në plotësimin e kolonave të trajtuara më sipër ka rezultuar që dhe rreshtat “Kosto historike” dhe “Amortizimi i akumuluar” në fund të periudhës të paraqiten në mënyrë jo të saktë, duke sjellë paraqitje të pasaktë të vlerave të kësaj pasqyre;

- Në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, ka të paraqitur jo saktë blerjet e mjeteve të transportit, ku shtesat janë shënuar në shumën 7,834,600 lekë dhe jo në shumën 6,956,400 lekë; Mos rakordimi i veprimeve të njëjta, në pasqyra të ndryshme dhe mos dhënia e referencave përkatëse është në kundërshtim me paragrafin 69 të SKK 1, ku përcaktohet se: “Nëse një informacion i të njëjtit transaksion ofrohet në pjesë të veçanta të pasqyrave financiare, atëherë pasqyrat financiare duhet të përmbajnë referencat përkatëse.”

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** në pasqyrën e pozicionit financiar nuk rakordon me shumën e paraqitur në regjistrin e kësaj klase llogarie. Nga llogaritjet e bëra nga grupi i auditimit të KLSH-së, mbi saktësinë e paraqitjes së zërave analitike të kësaj llogarie, rezultuan diferenca të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si në tabelën më poshtë:

*Tabela Nr.7: “Diferencat në llogaritjen e amortizimit dhe VKN-së për llogarinë 218 në vitet 2020-2023”*

*Në lekë*

Paraqitur sipas:	Amortizimi 2020	VKN 2020	Amortizimi 2021	VKN 2021	Amortizimi 2022	VKN 2022
<b>I.KLP</b>	1,897,803	9,893,335	2,895,267	9,117,320	2,221,848	7,124,735
<b>II.KLSH</b>	1,929,878	11,980,512	2,887,248	9,093,264	2,212,509	7,084,731
<b>Diferenca I-II</b>	(32,075)	(2,087,177)	8,019	24,056	9,339	40,004

*Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

Nga tabela më sipër vihet re se rezultojnë diferenca në shumat e amortizimeve vjetore dhe vlerave kontabël neto, kjo për shkak të pasaktësive të cilat janë si më poshtë:

- Amortizimi vjetor i vitit 2020 paraqitet i nënvlerësuar me 32,075 lekë, pasi artikulli me numër rendor 181, i cili ka hyrë në përdorim më datë 10.06.2020 nuk është amortizuar për 6 muajt e përdorur, përgjatë vitit 2020 e për pasojë shpenzimet e amortizimit për vitin 2020 janë nënvlerësuar me 23,125 lekë dhe artikulli me numër rendor 55, i hyrë në përdorim më 24.11.2022 nuk është amortizuar për muajin dhjetor 2020, duke nënvlerësuar amortizimin vjetor me 8,950 lekë;

- Vlera kontabël neto në vitin 2020 ka diferencë për shkak të mos llogaritjes së saktë të amortizimit vjetor në këtë vit dhe për shkak se në koston fillestare nuk janë përfshirë zëra të cilët kanë hyrë në përdorim më 31.12.2020, konkretisht artikujt me numër rendor 185-189, me një vlerë totale 2,157,600 lekë, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 8 të SKK 5;

- Në listën analitike të kësaj llogarie janë përfshirë 3 artikuj, të cilët nuk zotërohen nga KLP, por janë të marra me qira e si të tilla nuk duhet të ishin pjesë e llogarisë 218, në mënyrë të detajuar artikujt paraqiten si më poshtë:

Tabela Nr.8: “Diferencat në llogaritjen e amortizimit dhe VKN-së për llogarinë 218 në vitet 2020-2023”

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Vlera fillestare	Dt. e daljes në përdorim	Amortizimi 20	Amortizimi 21	VKN 21	Amortizimi 22	VKN 22
13	Kasaforte sigurie	23,976	08.06.22	-	-	-	2,997	20,979
116	Kasaforte sigurie	203,976	08.06.22	-	-	-	25,497	178,479
47	Kasaforte hekuri	1,310	22. 12. 21	-	-	-	328	983
<b>Totali</b>		<b>229,262</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>28,822</b>	<b>200,441</b>

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Prej përfshirjes së këtyre zërave në listën analitike, të llogarisë 218 VKN e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 mbivlerësohet me 200,441 lekë dhe shpenzimet e amortizimit për këtë vit mbivlerësohen me 28,822 lekë.
- Për artikujt me numër rendor 185-189, të cilat janë të llojit “mobilje”, klasifikimi në këtë klasë llogarie është i pasaktë, pasi nuk kanë të njëjtën natyrë me artikujt e tjerë dhe për to është aplikuar norma e amortizimit 20% dhe jo 25% siç është aplikuar për pjesën tjetër të artikujve.
- Artikujt me numër rendor 17 dhe 18 nuk kanë të paraqitur saktë datën e daljes në përdorim, konkretisht të dy artikujt kanë datën e hyrjes në subjekt më vonë se data e daljes në përdorim, konkretisht data e hyrjes 23.11.2021 dhe data e daljes në përdorim 10.06.2020.
- Artikujt me numër rendor 157 “Dell Monitor CN-02XT76” dhe 168 “Dell Monitor-CN-02XT76”, nuk i kanë të plotësuara kolonat përkatëse të regjistrimit të aktiveve, por vetëm kolonën e sasisë, të plotësuar me 1(një). Kjo për shkak se artikulli 156 ,157 dhe 167 dhe 168 janë një artikull i vetëm dhe për efekt të numërimit fizik janë ndarë në dy rreshta të veçantë, por vlera e tyre nuk mund të ndahet.
- Artikulli me numër rendor 172 “UPS” paraqet vetëm vlerën fillestare dhe nuk paraqet as sasinë as kolonat e tjera respektive të plotësuara në regjistrin e aktiveve, nga inventarizimi fizik i bërë në subjekt rezulton se për këtë artikull nga 20 njësi gjendje në kontabilitet ka rezultuar vetëm 1 njësi gjendje, e cila paraqitet në artikullin me numër rendor 54. Nga inventarizimi fizik për vitin 2021 rezulton se në lidhje me këtë artikull janë konstatuar 19 njësi në mungesë dhe ç’regjistrimi në regjistrin e llogarisë 218, nuk i është i pasqyruar saktë dhe nuk janë respektuar rregullat kontabël për sistemimin e diferencave nga inventarizimi. Në lidhje me ç’regjistrimin kontabël nuk ka asnjë urdhër të nëpunësit autorizues, kjo në kundërshtim me pikën 87 të UMFE Nr.30/2011.

**Kriteri:**

Pika 87 dhe 89 UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Pika 36 e UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Paragrafi 8 i SKK 5 “Aktivet Afatgjata”

Paragrafi 69 i SKK 1 “Kuatri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”

<b>Ndikimi/Pasoja:</b>	Aktivitet afatgjata materiale dhe shpenzimet e amortizimit nuk reflektojnë në mënyrë të saktë vlerën e tyre. Pasqyrat financiare paraqesin vlera të ndryshme nga krahasimi i zërave të njëjtë në pasqyra të ndryshme.
<b>Shkaku:</b>	Klasifikim i pasaktë i zërave në një klasë llogarie; mos llogaritje e saktë e amortizimit vjetor dhe mos paraqitje e saktë e shumave të shtesave të aktiveve afatgjata materiale.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	-Nëpunësi zbatues, i KLP-së të marrë masa për të ri paraqitur vlerat e AAM në mënyrë të saktë dhe korrigjimi i pasaktësive të rezultuara të bëhet në mënyrë retrospektive, sipas kërkesave të SKK-ve. -Nëpunësi zbatues i KLP-së të marrë masa në vijimësi, për të rakorduar informacionin e njëjtë të paraqitur mes pasqyrave të ndryshme financiare.

### Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2022

Në bazë të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Sekretari i Përgjithshëm Z. E. Ç ka dalë Urdhri Nr.171, datë 14.12.2022 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale dhe aktiveve afatshkurtra.” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<b>Pasaktësi në procedurat e regjistrimit të diferencave të rezultuara nga inventarizimi fizik i elementëve të Llogarisë 218 “Inventar ekonomik”</b>																																																													
<b>Situata:</b>	<p>Nga verifikimi i procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurta të realizuar pranë KLP-së në zbatim të urdhrimit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr.171, datë 14.12.2022 rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përbërja e komisionit për inventarizimin e aktiveve për 2 vite radhazi ka qenë e njëjtë për 4 nga 5 anëtarët, kjo në kundërshtim me pikën 84, të UMFE nr.30/2011, ku përcaktohet se: <i>“Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision”</i>.</li> <li>- Nga inventarizimi fizik i kryer kanë rezultuar mungesa në zërat e llogarisë Nr. 218 <i>“Inventar ekonomik”</i>, të cilat janë si më poshtë:</li> </ul> <p><i>Tabela Nr.8: “Mungesat e rezultuara nga inventarizimi fizik</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Në lekë</i></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Nr .</th> <th rowspan="2">Emërtimi</th> <th colspan="3">I. Sipas kontabilitet</th> <th colspan="2">II.Nga inventarizimi</th> <th colspan="2">III. Diferenca(II-I)</th> </tr> <tr> <th>Sasia</th> <th>Çmimi</th> <th>Vlera</th> <th>Sasia</th> <th>Vlera</th> <th>Sasia</th> <th>Vlera</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Personal computers Fujitsu</td> <td>20</td> <td>89,814</td> <td>1,796,280</td> <td>18</td> <td>1,616,652</td> <td>-2</td> <td>-179,628</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>External Display Fujitsu Display</td> <td>20</td> <td>28,578</td> <td>571,560</td> <td>18</td> <td>514,404</td> <td>-2</td> <td>-57,156</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>UPS</td> <td>20</td> <td>13,062</td> <td>261,240</td> <td>1</td> <td>13,062</td> <td>-19</td> <td>-248,178</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Shock Resistant external Hard Drive</td> <td>4</td> <td>16,320</td> <td>65,280</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-4</td> <td>-65,280</td> </tr> <tr> <td colspan="2"><b>Totali</b></td> <td><b>44</b></td> <td><b>57,960</b></td> <td><b>898,080</b></td> <td><b>19</b></td> <td><b>527,466</b></td> <td><b>-25</b></td> <td><b>-370,614</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Burimi i të dhënave: KLP, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së</i></p> <p>Nga tabela më sipër, konstatohet se nga inventarizimi fizik rezultojnë 370,614 lekë më pak zëra të inventarit ekonomik, të cilat kanë hyrë në institucion si pjesë e marrëveshjes së datës 31.12.2019 me Ambasadën A.</p>	Nr .	Emërtimi	I. Sipas kontabilitet			II.Nga inventarizimi		III. Diferenca(II-I)		Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	1	Personal computers Fujitsu	20	89,814	1,796,280	18	1,616,652	-2	-179,628	2	External Display Fujitsu Display	20	28,578	571,560	18	514,404	-2	-57,156	3	UPS	20	13,062	261,240	1	13,062	-19	-248,178	4	Shock Resistant external Hard Drive	4	16,320	65,280	-	-	-4	-65,280	<b>Totali</b>		<b>44</b>	<b>57,960</b>	<b>898,080</b>	<b>19</b>	<b>527,466</b>	<b>-25</b>	<b>-370,614</b>
Nr .	Emërtimi			I. Sipas kontabilitet			II.Nga inventarizimi		III. Diferenca(II-I)																																																					
		Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera																																																						
1	Personal computers Fujitsu	20	89,814	1,796,280	18	1,616,652	-2	-179,628																																																						
2	External Display Fujitsu Display	20	28,578	571,560	18	514,404	-2	-57,156																																																						
3	UPS	20	13,062	261,240	1	13,062	-19	-248,178																																																						
4	Shock Resistant external Hard Drive	4	16,320	65,280	-	-	-4	-65,280																																																						
<b>Totali</b>		<b>44</b>	<b>57,960</b>	<b>898,080</b>	<b>19</b>	<b>527,466</b>	<b>-25</b>	<b>-370,614</b>																																																						

	Gjithashtu, nga procesi inventarizimit të AASH dhe AAGJ-ve rezultoi se nga ana e nëpunësit Autorizues nuk është nxjerrë asnjë urdhër për ndjekje nga nëpunësi zbatues, në lidhje me masat për kompensim dhe sistemimin e diferencave, kjo në kundërshtim me pikën 87 dhe 93, të UMF Nr.30, datë 27.12.2011. Aktivët në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 nuk i paraqesin, zërat me vlerat përkatëse të evidentuara si mungesë. Sistemimet e vlerës kontabël me atë të rezultuar nga numërimi fizik janë kryer të pa mbështetura në një dokument justifikues, siç parashikohet në nënpikat a-c të pikës 35 të UMF Nr.30, datë 27.1.2011.
<b>Kriteri:</b>	Nënpikat a-c të pikës 35, pikat: 84, 87, 93 të UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
<b>Ndikimi/Pasoj a:</b>	Sistemimi kontabël i diferencave të rezultuara prej numërimit fizik, pa u bazuar në një dokumentacion justifikues, bën që të mos thellohet analiza e institucionit për gjetjen e personave përgjegjës për mungesat dhe njohjen e të drejtave ndaj tyre.
<b>Shkaku:</b>	-Nëpunësi zbatues nuk ka nxjerrë urdhër për sistemimin e diferencave të rezultuara nga inventarizimi fizik i aktiveve. -Nëpunësi zbatues ka ndërmarrë veprim korrigjues, pa u bazuar në një dokument justifikues, që mundëson inicimin e veprimit kontabël.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	- Nëpunësi autorizues të marrë masa për ngritjen e një komisioni për saktësimin e gjendjes së inventarit dhe në rastet e mungesave të evidentohen personat përgjegjës dhe të bëhen veprimet kontabël rregulluese të bazuara në Urdhrin e Nëpunësit Autorizues. - Nëpunësi zbatues të marrë masa për regjistrimin e gjendjes reale të aktiveve, në kundërshtim të mungesave të konstatuara, të njihen dhe të drejtat ndaj personave përgjegjës për mungesat, bazuar kjo në Urdhrin e Nëpunësit Autorizues.

### **PASIVET (DETYRIMET)**

Gjendja e llogarive të pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të KLP-së, më 31.12.2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

*Tabela Nr.7: “Pasivi i Bilancit Kontabël të KLP-së më 31.12.2022”*

Nr.	Ref e llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
65	B	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>9,431,834</b>	<b>9,100,716</b>	<b>331,118</b>
66		I. Pasivet Afat shkurtra	9,431,834	9,100,716	331,118
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,508,875	6,341,299	167,576
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,024,860	905,223	119,637
75	435	Sigurime Shoqërore	1,603,376	1,582,062	21,314
76	436	Sigurime Shëndetësore	294,723	272,132	22,591

*Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar paraqesin detyrimet e KLP-së më datë 31.12.2022, kundrejt pagave të punonjësve, detyrimet kundrejt organeve tatimore për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP), sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, të cilat njihen si detyrime në muajin kur ndodhin dhe paguhen në muajin pasardhës.



<b>Titulli i gjetjes:</b>	<b>Mbi paraqitjen e seksionit të detyrimeve afatshkurtra</b>																						
<b>Situata:</b>	<p>Për verifikim e saktësisë së paraqitjes së llogarisë 42, “<b>Detyrime ndaj personelit</b>”, në bilancin kontabël të datës 31.12.2022 u bë krahasimi i listë pagesës së mbajtur nga KLP me formularin e-sig 025 të muajit Dhjetor 2022, të gjeneruar nga sistemi i tatimeve (e-filling) ku rezultuan diferenca në detyrimin e KLP-së për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punëmarrësve. Konkretisht në listë pagesën e muajit dhjetor 2022 rezultoi se kontributet e sigurimeve shoqërore janë 3,125 lekë më pak dhe kontributet e sigurimeve shëndetësore 578 lekë më pak, veprim ky në kundërshtim më përcaktimet e pikave 1 dhe 2 të nenit 8 të Ligjit Nr. 9136, datë 11.09.2003, të ndryshuar. Në pasqyrën e pozicionit financiar detyrimi për TAP, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëmarrësit dhe punëdhënësit përputhen me shumën që paraqiten në formularin e-sig 025, por detyrimet për kontributet suplementare nuk paraqiten, gjithashtu paga neto nuk rezultoi e paraqitur saktë, në mënyrë të detajuar diferencat paraqiten si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;"><i>Tabela Nr.8 “Diferencat në zërat e llogarisë 42”</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Në lekë</i></p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: center;">Përshkrimi</th> <th style="text-align: center;">Shuma</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Paga Bruto gjithsej</td> <td style="text-align: right;">8,634,357</td> </tr> <tr> <td>Sigurimet. Shoqërore të Punëmarrësit</td> <td style="text-align: right;">981,369</td> </tr> <tr> <td>Sigurimet. Shoqërore të Punëdhënësit</td> <td style="text-align: right;">622,007</td> </tr> <tr> <td>Sigurimet shëndetësore gjithsej</td> <td style="text-align: right;">294,723</td> </tr> <tr> <td>Sigurimet Suplementare</td> <td style="text-align: right;">283,108</td> </tr> <tr> <td>TAP</td> <td style="text-align: right;">1,024,860</td> </tr> <tr> <td>Ndalesat gjithsej të punëmarrësit</td> <td style="text-align: right;">2,436,699</td> </tr> <tr> <td>A. Paga neto (Paga gjithsej – ndalesat e punëmarrësit)</td> <td style="text-align: right;">6,557,021</td> </tr> <tr> <td>B. Paga neto sipas Bilancit kontabël të datës 31.12.22 llog 42 “Detyrime ndaj personelit”</td> <td style="text-align: right;">6,508,875</td> </tr> <tr> <td><b>Diferenca(A-B)</b></td> <td style="text-align: right;"><b>48,146</b></td> </tr> </tbody> </table> <p style="text-align: center;"><i>Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022 dhe formulari e-sig 025, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së</i></p> <p>Nga tabela më sipër rezultoi se pagat neto në pasqyrën e pozicionit financiar janë nënvlerësuar me 48,146 lekë, ndërsa sigurimet suplementare, të cilat llogariten dhe deklarohen nga punëdhënësi (KLP), nuk rezultojnë të jenë të pasqyruara në pasiv të bilancit kontabël të datës 31.12.2022 çka bën që pasivi i bilancit kontabël të jetë i nënvlerësuar.</p>	Përshkrimi	Shuma	Paga Bruto gjithsej	8,634,357	Sigurimet. Shoqërore të Punëmarrësit	981,369	Sigurimet. Shoqërore të Punëdhënësit	622,007	Sigurimet shëndetësore gjithsej	294,723	Sigurimet Suplementare	283,108	TAP	1,024,860	Ndalesat gjithsej të punëmarrësit	2,436,699	A. Paga neto (Paga gjithsej – ndalesat e punëmarrësit)	6,557,021	B. Paga neto sipas Bilancit kontabël të datës 31.12.22 llog 42 “Detyrime ndaj personelit”	6,508,875	<b>Diferenca(A-B)</b>	<b>48,146</b>
Përshkrimi	Shuma																						
Paga Bruto gjithsej	8,634,357																						
Sigurimet. Shoqërore të Punëmarrësit	981,369																						
Sigurimet. Shoqërore të Punëdhënësit	622,007																						
Sigurimet shëndetësore gjithsej	294,723																						
Sigurimet Suplementare	283,108																						
TAP	1,024,860																						
Ndalesat gjithsej të punëmarrësit	2,436,699																						
A. Paga neto (Paga gjithsej – ndalesat e punëmarrësit)	6,557,021																						
B. Paga neto sipas Bilancit kontabël të datës 31.12.22 llog 42 “Detyrime ndaj personelit”	6,508,875																						
<b>Diferenca(A-B)</b>	<b>48,146</b>																						
<b>Kriteri:</b>	<p>-Listë pagesa e-sig 025 i gjeneruar nga sistemi i tatimeve e-filling.</p> <p>-Pikat 1 dhe 2 të nenit 8, pika 2 e nenit 6, të Ligjit Nr.9136, datë 11.09.2003, i ndryshuar.</p>																						
<b>Ndikimi/Pasoja:</b>	Mos paraqitja e saktë e shumës së detyrimeve ndikon në paraqitjen jo të saktë të detyrimeve ndaj institucioneve të tjera gjithashtu, pagat neto të kaluara në favor të punonjësve rezultojnë të jenë më të ulta në muajin Dhjetor 2022 në shumën 48,148 lekë.																						
<b>Shkaku:</b>	Mos llogaritje e saktë e ndalesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe mos reflektim i plotë i të gjithë detyrimeve (kontributet suplementare) në pasqyrën e pozicionit financiar.																						
<b>Rëndësia:</b>	E mesme																						
<b>Rekomandimi:</b>	Nga sektori i Financës të merren masa, që listë pagesat e përgatitura prej tij, që shërbejnë si bazë në përlllogaritjen e pagave neto, të bëhen paraprakisht rakordimet me formularin e-sig 025 dhe ndalesat e mbajtura																						

	të punëmarrësve për efekt të kontributeve suplementare, të paraqiten në bilancin kontabël, për të mundësuar një pamje reale të detyrimeve në datën e fundit të vitit ushtrimor.
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”** në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në shumën 1,024,860 lekë dhe paraqet vlerën e pa paguar për tatimin e të ardhurave nga punësimi për muajin dhjetor 2022, që paguhet në muajin janar 2023, shuma e paraqitur në Bilancin Kontabël përputhet me shumën sipas listë pagesës së muajit dhjetor 2022, të deklaruar në sistemin e-filling të tatimeve.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqesin vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për muajin dhjetor 2022, të cilat paguhet në muajin janar 2023. Ato janë në vlerat 1,603,376 lekë dhe 294,723 lekë të cilat përputhen me ato të paraqitura në listë pagesën e muajit dhjetor 2022.

### FONDI I KONSOLIDUAR

Në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022, fondi i konsoliduar paraqitet në shumën 38,864,765 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 42,145,859 lekë.

Gjendja e fondit të konsoliduar është diferencë e shumës së aktiveve në vlerën 48,296,599 lekë me pasivet në vlerën prej 9,431,834 lekë. Nga verifikimi i bërë kësaj llogarie rezulton se Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” nuk është plotësuar, kurse në pasqyrën e performancës financiare paraqitet në shumën 670,180 lekë.

### Formati Nr.2 “Pasqyra e Performancës Financiare”

Pasqyra e performancës financiare, për vitin 2022 nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë është përgatitur bazuar në klasifikimin sipas natyrës ekonomike, për vitin 2022 kjo pasqyrë paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr.9: “PASH e vitit 2022 për KLP”

Në lekë

Nr. rreshti	Nr. Llogarie	PERSHKRIMI I OPERACIONEVE	2022	2021
1	A	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>142,556,928</b>	<b>133,988,867</b>
2	70	/ . TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0
53	72	V. GRANTE KORENTE	141,886,748	133,988,867
54	720	I. Grant korent i Brendshëm	141,886,748	133,988,867
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	141,886,748	133,988,867
73	73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARE TE PRODUKTEVE</b>	<b>670,180</b>	
74	B	<b>SHPENZIMET</b>	<b>141,886,748</b>	<b>133,988,867</b>
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	102,730,407	88,847,261
76	6001	Paga, personel i përhershëm	102,730,407	88,847,261
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	12,898,586	11,465,491
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	12,898,586	11,465,491
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	25,587,575	33,676,115
85	6020	Materiale zyre e te përgjithshme		1 638 466
87	6022	Shërbime nga te trete		20 205 260
88	6023	Shpenzime transporti		4 842 133
89	6024	Shpenzime udhëtimi		1 191 845
91	6026	Shpenzime për qiramarrje		3,756,914
92	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		786,365
94	6029	Shpenzime te tjera operative		1,255,132
95	603	IV.SUBVEZIONE	0	0
130	63	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>670,180</b>	0
132	85	TEPRICA OSE DEFICIT) I PERIUHDHES (Rezultati I Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)	670,180	

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga analizimi i pasqyrës së performancës financiare përsa i përket të ardhurave rezultojn se të ardhurat e KLP-së në shumën 142,556,928 lekë i përkasin dy kategorive: Llogarisë 7200 “Grant koherent i brendshëm NJQP”, në shumën 141,886,748 lekë dhe llogarisë 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarëve dhe produkteve” në shumën 670,180 lekë.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në paraqitjen e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas PASH dhe sipas Akt-rakordimit me Degën e Thesarit																																			
<p><b>Situata:</b></p>	<p>Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së të ardhurave të raportuara në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2022 (PASH) rezultoi se të ardhurat totale të raportuara në PASH janë 142,556,928 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit Nr. 331, datë 23.02.2023 me Degën e Thesarit, Tiranë paraqiten në shumën <b>141,986,569 lekë ose 99,821 lekë më pak</b>. Në mënyrë të detajuar diferencat mes zërave të ardhurave dhe shpenzimeve sipas PASH dhe sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë, paraqiten si në tabelën më poshtë:</p> <p style="text-align: center;">Tabela Nr. 10 “Diferencat në zërat e PASH dhe të dhënave sipas akt rakordimeve” Në lekë</p> <table border="1" data-bbox="472 831 1416 1014"> <thead> <tr> <th>Llog</th> <th>Emri llogarisë</th> <th>I.PASH</th> <th>II. Realizimit</th> <th>Dif( I-II)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Të ardhura totale</td> <td>142,556,928</td> <td>142,545,475</td> <td>11,453</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Shpenzime totale</td> <td>141,886,748</td> <td>141,986,569</td> <td>(99,821)</td> </tr> <tr> <td>600</td> <td>Paga dhe përfitime të punonjësve</td> <td>102,730,407</td> <td>102,730,407</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>601</td> <td>kontributet e sigurimeve</td> <td>12,898,586</td> <td>12,898,586</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>602</td> <td>Blerje mallra dhe shërbime</td> <td>25,587,575</td> <td>25,284,241</td> <td>303,334</td> </tr> <tr> <td>606</td> <td>Transferime për buxhetet familjare dhe individë</td> <td>-</td> <td>1,073,335</td> <td>(1,073,335)</td> </tr> </tbody> </table> <p style="text-align: center;"><i>Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së</i></p> <p>Nga tabela më sipër rezultojn se:            Klasa 602 “Blerje e mallrave e shërbime” paraqitet në PASH në shumën 25,587,575 lekë ndërsa sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit, shpenzimet e realizuara për këtë klasë llogarie paraqiten në shumën 25,284,241 lekë, pra 303,334 lekë më pak.            Klasa 606 “Transferime për Buxhetet familjare dhe individë”, në PASH paraqitet zero, ndërsa sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit kjo shumë paraqitet në vlerën 1,073,335 lekë.            Gjithashtu nga verifikimi i paraqitjes së pasqyrës së performancës financiare rezultojn se në plotësimin e saj, totali i klasës 602 “Blerje e mallrave e shërbime” paraqet vetëm totalin dhe nuk paraqitet e plotësuar në nën llogaritë përkatëse.            Nga grupi i auditimit u verifikua dhe lista e urdhër shpenzimeve, vënë në dispozicion nga sektori u financës, nga ku rezultoi se shuma progresive vjetore për llogarinë 600 është 102,812,328 lekë, për llogarinë 601 në vlerën 12,898,586 lekë, për llogaritë 302 në shumën 25,284,510 lekë dhe për llogaritë 606 në shumën 1,073,335 lekë, çka tregon se shpenzimet e regjistruara gjatë periudhës ushtrimore <b>nuk janë të reflektuara saktë në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022.</b></p>	Llog	Emri llogarisë	I.PASH	II. Realizimit	Dif( I-II)	A	Të ardhura totale	142,556,928	142,545,475	11,453	B	Shpenzime totale	141,886,748	141,986,569	(99,821)	600	Paga dhe përfitime të punonjësve	102,730,407	102,730,407	-	601	kontributet e sigurimeve	12,898,586	12,898,586	-	602	Blerje mallra dhe shërbime	25,587,575	25,284,241	303,334	606	Transferime për buxhetet familjare dhe individë	-	1,073,335	(1,073,335)
Llog	Emri llogarisë	I.PASH	II. Realizimit	Dif( I-II)																																
A	Të ardhura totale	142,556,928	142,545,475	11,453																																
B	Shpenzime totale	141,886,748	141,986,569	(99,821)																																
600	Paga dhe përfitime të punonjësve	102,730,407	102,730,407	-																																
601	kontributet e sigurimeve	12,898,586	12,898,586	-																																
602	Blerje mallra dhe shërbime	25,587,575	25,284,241	303,334																																
606	Transferime për buxhetet familjare dhe individë	-	1,073,335	(1,073,335)																																
<b>Kriteri:</b>	Pikat 39-41, të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018,																																			
<b>Ndikimi/Pasoja:</b>	Mosparaqitje e saktë e vlerës së llogarive 600, 601, 602 dhe 606																																			

<b>Shkaku:</b>	Mos marrja në konsideratë e shumave të akt rakordimeve me Degën e Thesarit, që të mundësohej rakordimi i saktë i zërave dhe të bëheshin reflektimet përkatëse.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e financës, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të marrë masa për të pasqyruar saktë në vijimësi vlerat e llogarive të klasës 601, 602 dhe 606, në pasqyrat financiare dhe të bëhen sistemitet përkatëse.

### Pasqyra e Flukseve të mjeteve monetare (Cash Flow)

Pasqyra Cash Flow për Këshillin e Lartë të Prokurorisë është përgatitur sipas metodës direkte, dhe nga testet e bëra në lidhje me verifikimin e zërave të paraqitur në këtë pasqyrë rezultoi se rubrika Nr.1 “Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente” në shumën 141,775,475 lekë nuk përputhet me vlerën e paraqitur sipas akt rakordimit Nr. 331, datë 23.02.2023 me Degën e Thesarit, Tiranë, ku shuma sipas këtij të fundit paraqitet në vlerën 142,545,475 lekë, rubrika Nr.3 “Pagesa për detyrime e shpenzime korente” sipas pasqyrës Cash Flow paraqitet në shumën 141,216,568 lekë ndërsa shumatorja e shpenzimeve korrente sipas ditarit të arkës paraqitet në shumën 141,986,569 lekë.

### Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Nga verifikimi i bërë prej grupit të auditimit në lidhje me saktësinë e paraqitjes së shumave në këtë pasqyrë rezultoi se zërat analitikë të fondeve neto të paraqitura, nuk përkojnë me gjendjen e zërave analitikë përkatës të seksionit të aktiveve neto, të bilancit kontabël të datës 31.12.2022, në mënyrë të detajuar situata paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr.11: “Aktivet neto sipas pasqyrave : F1 dhe F4”

Në lekë

Nr I Llog	Emërtimi	Aktive neto në fillim (F4)	Rezultatet e ushtrimit Tepricë/deficit	Aktive neto në fund (F4)	Aktive neto në fund F1
101	Teprica (fondi i akumuluar)/Deficit i akumuluar	-			<b>38,864,765</b>
105	Nga grantet e brendshme kapitale (+)	42,145,859	12,001,541	54,147,400	-
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)		(670,180)	(670,180)	
1013	Nga Konsumi I AAGJ		(14,612,455)	(14,612,455)	
	<b>Totali I fondeve të veta sipas F4</b>	<b>42,145,859</b>	<b>(3,281,094)</b>	<b>38,864,765</b>	

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se:

-Rezultati i vitit ushtrimor në shumën +670,180 lekë (diferencë mes të ardhurave dhe shpenzimeve totale) është shënuar me shenjë negative dhe paraqitet vetëm në pasqyrën e aktiveve neto (F4), ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar kjo shifër nuk paraqitet.

-Konsumi i aktiveve afatgjata në shumën 14,612,455 lekë nuk përputhet me shifrën e amortizimit vjetor të AAGJ-ve, bazuar në regjistrat e aktiveve.

-Gjithashtu shuma 12,001,541 lekë rezultat i ushtrimit nga grantet e brendshme nuk është e arsyetuar nga është marrë.

Sipas nën pikës 3 të pikës 82, të UMFE Nr.8 datë 09.03.2018 përcaktohet se: “Totali i fondeve të veta të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në

F4-“Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”

*rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar” nga verifikimi i kryer rezulton se shumat totale të pasqyrës F4 rakordojnë më totalin e aktiveve/fondeve neto në seksionin c të pasqyrës F1, por shumat e shënuara në kolonën 5 të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet/fondet neto **nuk është e paraqitur saktë.***

### **Pasqyra statistikore “Investimet dhe burimet e financimit” (F6)**

Pasqyra e “Investimeve dhe burimeve të financimit” për vitin 2022 nuk rezulton të jetë plotësuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikat 83-86 të Udhëzimit të MFE Nr. 8 datë, 09.03.2018, të ndryshuar. Kjo pasqyrë statistikore nuk është e paraqitur në mënyrë të saktë, konkretisht kolona “f” e pasqyrës nuk është plotësuar për shumën e shpenzimeve për investimeve por vetëm në shumën e burimeve të financimit në seksionin e dytë të kësaj pasqyre, dhe për rrjedhojë seksioni i tretë i kësaj pasqyre (balanca burime për investime-shpenzimet për investime) është paraqitur sa totali i investimeve të realizuara.

### **Pasqyra statistikore 7/a dhe 7/b**

Në lidhje me këto pasqyra statistikore rezultojnë **të ketë pasaktësi** në paraqitjen e tyre, të cilat janë trajtuar më lart në material në seksionin e AAM, të pasqyrës së pozicionit financiar të datës 31.12.2022.

### **Pasqyra statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (F8)**

Nga verifikimi i bërë kësaj pasqyre rezulton se kolona 1 e saj është **keq paraqitur** pasi është plotësuar mbi numrin e plotë të punonjësve sipas secilës kategori (drejtues, specialist, teknikë, punëtor, nëpunës i thjeshtë, punonjësi i përkohshëm), kur në fakt kolona duhet plotësuar vetëm në lidhje me punonjësit e pranuar gjatë vitit sipas secilës kategori, kolona 7 “Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” paraqitet në shumën 12,872,831 lekë ndërsa në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve , paraqitet në shumën 12,898,586 lekë, pra një diferencë në shumën 25,755 lekë më pak se në PASH.

### **Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.**

*Për testimin e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës nga grupi i auditimit u bë përzgjedhja rastësore e 16 praktikave të shpenzimeve me vlerë totale 28,306,326 lekë të paguara nëpërmjet bankës dhe u verifikua nëse janë të shoqëruara me dokumentacionet justifikuese përkatëse dhe si është bërë kontabilizimi i tyre.*

*Nga testi i kontrollit për vitin 2022 në lidhje me veprimet me bankë rezultoi:*

*Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë.

U auditua procedura në lidhje me përllogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa u përzgjedhën 4 muaj për verifikim më konkretisht muaji Mars, Korrik, Tetor dhe Dhjetor të vitit 2022, nga ku rezultoi se:

- Llogaritja e pagave është bërë në përputhje me kategoritë e pagave;
- Pagesa e pagave neto e ndalesave është bërë brenda muajit pasardhës, nga ku u konfirmuan dhe dokumentacionet përkatëse që shoqëronin praktikatat e pagesës nëpërmjet bankës si: listë prezencat ditore, listë pagesat, lista e pagave që është dërguar në bankë, lista bashkë me dokumentin e pagesës të nënshkruar dhe vulosur nga banka si dhe urdhër shpenzimet përkatëse;
- Llogaritja e ndalesave është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe pagesa e tyre është bërë sipas detyrimeve të rezultuara nga formulari e-sig 025 të sistemit të tatimeve e-filling, por në listë pagesën ku KLP bën llogaritjet e pagave, **rezulton se ka diferenca** në ndalesat dhe për pasojë në pagat neto, të cilat në muajt e përzgjedhur diferencat paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela Nr. 12 “Diferencat në pagat neto mes listë pagesës së përgatitur nga KLP dhe asaj në sistemin e-filling ( e-sig 025)”

Lekë

Muaji	kaluar ne banke	Pg neto sipas E-sig 025	diferenca
Mars	5,968,542	5,983,604	(15,062)
Korrik	5,811,810	6,019,252	(207,442)
Tetor	9,326,335	9,603,661	(277,326)
Dhjetor	6,623,238	6,557,021	66,217

Burimi i të dhënave: KLP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se në muajt e përzgjedhur kanë rezultuar diferenca në pagat neto sipas sistemit e-filling të tatimeve dhe listë pagesave të mbajtura nga KLP, të cilat shërbejnë si bazë në përllogaritjen e pagave neto për personelin, konkretisht në muajin mars janë paguar 15,062 lekë më pak, në muajin korrik 207,442 lekë më pak, në muajin tetor 277,326 lekë më pak dhe në muajin dhjetor 2022 66,217 lekë më shumë. Për verifikimin e saktësisë së veprimeve të realizuara me bankë, u bë përzgjedhja e 12 praktikave të shpenzimeve të kryera në mënyrë rastësore dhe për secilin rast u verifikua plotësia dhe saktësia e dokumentacionit justifikues, që shoqëronte praktikën përkatëse. Transaksionet e përzgjedhura për verifikim paraqiten si më poshtë:

Tabela Nr. 13: “Transaksionet e shpenzimeve të përdorura për testim nga grupi i auditimit të KLSH-së”

Lekë

Data	Pagesa për:	Shuma
03.08.2022	Tatime sigurime prapambetur	442
10.08.2022	Pagesë për pasaportë	7,500
12.10.2022	S. Kasko A.....K	51,110
26.10.2022	2Lëb mail server	49,500
27.12.2022	Blerje bilete avioni A.T	97,200
27.12.2022	Blerje karburant	156,597
27.12.2022	Blerje goma për automjete	120,000
28.12.2022	Ndërmarrja ashensorë korrik 2022	6,713
28.12.2022	Ndërmarrja ashensorë Gusht 2022	6,713
28.12.2022	Ndërmarrja ashensorë Shtator 2022	6,713
28.12.2022	Ndërmarrja ashensorë Tetor 2022	6,713
28.12.2022	O. M Lavazh Shtator -Dhjetor	67,200

Burimi i të dhënave: KLP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-se

Nga verifikimi i bërë praktikave të mësipërme rezultoi se:

Dokumentacioni justifikues është i plotë dhe pagesat nëpërmjet bankës janë të mbështetura në dokumentacionet justifikuese përkatëse dhe të plota dhe sipas urdhrave të titullarit dhe urdhër shpenzimeve përkatëse.

#### **IV. Inventarizimi i pronës Shtetërore.**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk zotëron elementë të pronës shtetërore, ajo ushtron veprimtarinë në ambientet e “Polit të Drejtësisë”, kjo bazuar në Kontratën e Huapërdorjes Nr. 251, datë 14.07.2020 midis KLP-së dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të përfaqësuar nga Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë.

#### ***Sa më sipër, arrihet në konkluzionet se:***

- Formatet e paraqitjes së pasqyrave financiare nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë respektuar, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse.*
- Në aktivet afatgjata materiale paraqiten pasaktësi në lidhje me vlerat kontabël neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar, të cilat janë, jo materiale dhe të pa përhapura.*
- Nga inventarizimi i AAM kanë rezultuar diferenca (mungesa) për të cilat nuk janë ndërmarrë veprime nga nëpunësi autorizues, por që në kontabilitet janë hequr nga lista e aktiveve pa pasur një urdhër të veçantë dhe pa bërë veprimet sistemuese përkatëse.*
- Paraqitja e Pasqyrave Financiare ka elementë të paraqitur në mënyrë të pasaktë, të cilat janë jo materiale, por jo të përhapura.*

#### **2.4.Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit).**

Në zbatim të pikës II/4 “**Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit**” të programit të auditimit Nr. 104/1, datë 29.01.2024”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me Vendimin Nr.405, datë 28.12.2023;
- Deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm 2021-2023;
- Struktura organike miratuar me Vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.36, datë 06.03.2019 dhe Nr.73, datë 24.04.2023 i ndryshuar;
- Korrespondenca zyrtare në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Auditimi u fokusua në këto çështje:

- Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit
- Menaxhimi i riskut
- Veprimtaritë e kontrollit
- Informim komunikimi
- Monitorimi

Nga auditimi:

## **I. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit.**

Vlerësimi i **Mjedisit të kontrollit** u bazua në komponentët më poshtë:

### **1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;**

Në zbatim të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, Kap. III, pika 3.1 sanksionohet:

*“Kquadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje”.* Në zbatim të këtij detyrimi ligjor KLP në lidhje me integriteti personal dhe etikën profesionale, ka hartuar dhe miratuar për vitin 2019, “Manualin e përshkrimit të punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Për vitin 2021-2023 është miratuar dhe Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” miratuar me Vendimin Nr.407, datë 17.12.2021 të KLP-së, gjithashtu është hartuar dhe miratuar Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” miratuar me Vendimin Nr.405, datë 28.12.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në lidhje me etikën profesionale të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me Vendimin Nr.380, datë 30.11.2023 të KLP-së, është miratuar Rregullore “Për miratimin e rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”. Në lidhje me etikën profesionale të punonjësve të Administratës së KLP-së në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” në nenin 28, i cili përmban 10 pika, janë parashikuar rregullat për zbatimin e etikës në punë nga punonjësit e administratës së KLP-së, të cilët duhet t’u përmbahen normave të etikës në administratën publike. Përfshirja në një nen të vetëm të Rregullores i normave të etikës për nëpunësit/punonjësit, përmbush në mënyrë të përgjithshme sjelljet etike në punë dhe pse Administrata e KLP-së nuk ka në format fizik një Kod Etike më vete.

### **2) Politikat menaxheriale dhe stili i punës;**

Në lidhje me politikat menaxheriale dhe stilin e punës një ndër fushat që merr prioritet është mbështetja e titullarit në drejtim të kontrollit të brendshëm dhe monitorimi i zbatimit të tij, krijimi i kushteve për zhvillimin e Auditit të Brendshëm, i cili do të raportojë drejtpërdrejt tek Nëpunësi Autorizues (NA) dhe Titullari i njësisë publike.

**Konstatim:** Në strukturën organike të miratuar me Vendimin Nr. 36, datë 06.03.2019 të KLP-së me numër punonjësish në total 65, si dhe në strukturën e miratuar me Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 të ndryshuar me numër punonjësish në total 72, nuk është përfshirë struktura e Auditit të Brendshëm, si njësi më vete, në mënyrë që të përmbush rolin e saj si njësi që ofron garanci dhe jep rekomandime, në mënyrë që i gjithë sistemi i MFK-së të funksionojë me efektivitet. Referuar VKM 83 Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” bazuar në pikën 6 germa a) “Njësitë publike, te cilat nuk plotësojnë kriteret për krijimin e njësive të auditimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe nuk kane varësi nga ndonjë organ epror, e sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm, nëpërmjet: marrëveshjes midis titullarëve të njësive publike përkatëse, të cilat kanë njësi të auditimit të brendshëm...”



Në lidhje me mungesën e strukturës së auditit të brendshëm, KLP në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2022, paraqitur në MFE me shkresën Nr.343/2 Prot, datë 27.02.2023, e ka vënë në dukje një fakt të tillë duke u shprehur për “mungesën e sektorit të auditimit”.

Ngritja e strukturës së auditit të brendshëm është kërkesë dhe e Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar neni 178, pika 2, germa “a” ku përcaktohet se “...Këshilli vendos për sa më poshtë: a) strukturën e administratës dhe të secilës njësi; b) krijimin e njësive të tjera organizative brenda administratës...”, si dhe e Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar neni 3, germa “a” ku përcaktohet se “Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike...”, si dhe në nenin 10, pika 1, germa “b” sipas të cilit “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në vijim: ...kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror, ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat...”.

Mungesa e njësisë së auditit të brendshëm është evidentuar dhe nga Drejtoria e Harmonizimit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK) pranë MFE e cila në Projekt raportin e vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për KLP-në për vitin 2023, përcjellë në KLP me shkresën Nr.4417/1 datë 22.06.2023 ka rekomanduar që “Nëpunësi Autorizues mund të monitorojë sistemin e KB nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike”.

KLP ka hartuar dhe miratuar objektivat afatmesëm dhe vjetorë në dokumentin PBA 2021-2023 dhe 2022-2024, ku janë përcaktuar programet buxhetore dhe investimet në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9, pika 4, germa “a”, ku përcaktohet: “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

a)propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi....”.

-Për vitin 2021-2023, me Urdhrin Nr.61, datë 26.06.2020 të KLP-së është ngritur Grupi për menaxhimin strategjik (GMS), i cili ka funksionuar deri në hyrjen në fuqi të Urdhrit Nr.12, datë 19.01.2023, në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar nenit 8, pika 8/b, ku përcaktohet se “Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: “..ngritjen e **grupit të menaxhimit strategjik** të njësisë publike”.

Gjithashtu për vitet respektive 2021-2023 është ngritur ekipi i menaxhimit të programeve buxhetore (EMP) me Urdhrin Nr.61, datë 26.06.2020 i cili ka funksionuar deri në hyrjen në fuqi të Urdhrit Nr. 11, datë 19.01.2023.

GMS dhe EMP për vitet objekt auditimi 2021-2023 është mbledhur për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024, 2023-2025 dhe 2024-2026.

Për vitin 2021, është mbledhur në 2 raste, faza e parë, që është përcjellë në MFE me shkresën Nr.755/1, datë 01.05.2021 dhe për fazën e dytë që është përcjellë në MFE me shkresën Nr.1957/1, datë 01.09.2021. Për vitin 2022, është mbledhur në 3 raste, faza e parë, që është përcjellë në MFE me shkresën Nr.549/1, datë 06.05.2022, për fazën e dytë që është përcjellë me shkresën Nr.1874/1,

datë 30.08.2022 dhe për fazën e tretë mbi përditësimin e të dhënave në sistemin AFMIS përcjellë në MFE me shkresën Nr. 2430/1, datë 20.12.2022.

Për vitin 2023, është mbledhur në 2 raste ku, për fazën e parë programi buxhetor afatmesëm është përcjellë në MFE me shkresën Nr.985/1, datë 08.05.2023 dhe për fazën e dytë përcjellë në MFE me shkresën Nr.2033/1, datë 30.08.2023. Kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit ligjor në MFE.

Mbledhjet e GMS-së dhe EMP-së nuk janë të pasqyruara sipas një protokollit mbledhjeje por ato formalizohen përmes relacioneve përkatëse bashkëlidhur hartimit të kërkesave buxhetore, i cili nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

3) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019, KLP ka miratuar strukturën organizative e cila ka shtrirë fuqinë deri në miratimin e strukturës së re me Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 i ndryshuar. Struktura organike është reflektuar dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë” e cila është publikuar në faqen zyrtare të KLP-së me qëllim njohjen e saj nga punonjësit.

Konstatim: Për periudhën objekt auditimi (2021-2023) struktura organike është e pa plotësuar në numër, si më poshtë:

-Dhjetor 2021, vende të lira/vakante (2), për pozicionet: drejtor kabineti (1) dhe nëpunës informacioni (1).

-Dhjetor 2022, vende të lira/vakante (4) për pozicionet: Drejtor Departamenti i Shërbimeve Ligjore (1), Këshilltar ligjor në Drejtorinë e Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve (1), teknik mirëmbajtje (2).

-Dhjetor 2023, vende të lira/vakante (5) për pozicionet: këshilltar ligjor në Drejtorinë e Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve (1), specialist i burimeve njerëzore (1), specialist TIK (1) dhe shofer (1).

Rregullorja përcakton ndarjen e detyrave, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 20.

Emërimi i Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Nëpunësit Zbatues (NZ) është bërë me shkresën Nr.1349/2, datë 28.09.2020, konfirmuar dhe nga MFE me shkresën Nr.18057/1, datë 08.10.2020.

4) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe veprimet disiplinore, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Burimet njerëzore, referuar strukturës së miratuar menaxhohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve. Sektori mbulon çështjet që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit, emërimit dhe lirimimit nga detyra apo shërbimi civil, procedurat disiplinore, administrimin e dosjeve të personelit, plotësimin e regjistrit qendror të personelit, përgatitjen e përshkrimeve të punës. Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike administron trajnimet dhe kualifikimet e stafit. Për periudhën Janar 2021-Maj 2022, janë realizuar trajnimet për stafin e administratës së KLP-së nga ASPA. Për vitin 2023, në përgjigje të shkresës Nr.1031 Prot, datë 18.10.2022 të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, janë dërguar nevojat për trajnim/fushat përkatëse me postë elektronike me e-mail datë 08.11.2022.

5) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Aftësitë profesionale të punonjësve janë në dinamikë të vazhdueshme, pasi nga ASPA organizohen trajnime të ndryshme në mënyrë që punonjësit të ngrihen profesionalisht.

## **II. Menaxhimi i riskut.**

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08. 07. 2010 (ndryshuar), nenin 8, germa “a” dhe nenin 21, pika 2, përcaktohet:

*“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planeveprimeve për arritjen e objektivave”.*

Konstatim: Nga KLP nuk është hartuar dhe miratuar regjistri i risqeve për institucionin për vitin 2021-2022, jo në përputhje Ligjin Nr.10296, datë 08. 07. 2010 (ndryshuar), nenin 8, germa “a” dhe nenin 21, pika 2. Mungesa e këtij regjistri është pasqyruar nga vetë KLP dhe në pyetësin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar, dërguar në MFE me shkresën Nr.343/2 Prot, datë 27.02.2023. Institucioni ka hartuar Manualin për strategjinë e Menaxhimit të riskut, miratuar nga Nëpunësi Autorizues/Sekretar i Përgjithshëm, me Nr.2717/1, datë 12.12.2023.

## **III. Veprimtaritë e kontrollit.**

Me qëllim reduktimin e risqeve për të arritur objektivat e njësisë, vendoset dhe sistemi me dy firma, procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare të tilla si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet etj. autorizohen pas hedhjes së firmës nga: Nëpunësi Zbatues (NZ) ose nëpunësi i deleguar/përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet, titullari/Nëpunësi Autorizues (NA), apo një nëpunës tjetër i deleguar, përgjegjës për kryerjen e shpenzimeve dhe mbledhjen e të ardhurave. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare apo buxhetore. Në lidhje me rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore, për vitin 2022, ka 5 (pesë) raste të lirimit nga detyra të punonjësve me shërbim civil, të cilët kanë dorëzuar detyrën dhe dokumentacionin e administruar prej tyre me procesverbal, në përputhje me VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 19, 20, 21 dhe 22. Harta e proceseve të punës është formalizuar dhe formatizuar me miratimin e “Manualit për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë” miratuar me Vendimin e KLP-së Nr.150, datë 22.07.2019 dhe “Manuali për përshkrimin e punëve në Administratën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë” për vitin 2023 miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Referuar Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar neni 92, pika 2, germa “e” përcaktohet se “Në përputhje me politikën e përgjithshme në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit, KLP, në bashkëpunim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë është përgjegjës për: ... e) përmirësimin periodik të sistemit, për të siguruar zbatimin e kërkesave funksionale të gjykatave, të vetë Këshillit dhe të **organeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë**, si dhe për të reflektuar ndryshimet në ligjet procedural...”. Në funksion të këtij detyrimi ligjor dhe atij të përcaktuar në VKM Nr. 972, datë 2.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”, Bordi drejtues i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI), në pikën 10, ushtron kompetencat si më poshtë:

*“...gj) miraton masa që sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit të gjenerojnë informacionin statistikor që nevojitet për punën e të gjitha institucioneve në sistemin e drejtësisë, në konsultim të ngushtë me institucionet përkatëse; h) miraton strategjinë e përgjithshme dhe vizionin lidhur me teknologjinë e informacionit për institucionet e sistemit të drejtësisë, si dhe miraton plane strategjike afatgjata për teknologjinë; i) miraton arkitekturën e strukturën e*

sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet e miratuara; j) mbikëqyr zbatimin e specifikimeve teknike për sistemet e teknologjisë së informacionit të sistemit të drejtësisë; k) informon institucionet e sistemit të drejtësisë, çdo vit, lidhur me gjendjen e përdorimit e të funksionimit të sistemeve të tyre të teknologjisë së informacionit”.

#### **IV. Informim komunikimi**

Shkëmbimi i informacionit realizohet ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Në Rregulloren e brendshme janë përshkruar proceset e punës, sjellja e etike gjatë punës, marrëdhëniet me njëri tjetrin, mënyra e raportimit dhe e bashkëpunimit. Komunikimi i informacionit realizohet përmes shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe përmes postës elektronike/e-mail. Komunikimi i brendshëm në KLP dhe komunikimi me institucionet e tjera, kryhet edhe nëpërmjet rrjetit informatikë/postës elektronike, ndërkohë që çdo mbledhje e Këshillit publikohet në faqen zyrtare të KLP-së. Komunikimi dhe shkëmbimi i dokumenteve zyrtare nga nëpunësit e administratës së KLP-së kryhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike të KLP-së.

#### **V. Monitorimi**

Referuar përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit “*monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur*”.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari realizohet nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm. Për sa më sipër, për periudhën e audituar 2021-2023, KLP ka përgatitur brenda afatit ligjor në dhe në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 18, Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Raportin vjetor për vitin 2021, 2022 dhe 2023 dërguar në MFE (DH/AB) me shkresat respektive: Nr.2642/1, datë 23.02.2022, Nr.343/2, datë 27.02.2023 dhe Nr.508/1 Prot, datë 21.02.2024.

#### ***Sa më sipër, arrihet në konkluzionet se:***

Në lidhje me funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitet objekt auditimi (2021-2023) u konstatua se:

-mungesa e njësisë së auditit të brendshëm jo në përputhje me Ligjin Nr.114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar neni 3, germa “a” dhe nenin 10 pika 1 germa b sipas te cilit “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3 të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njëres prej formave të përcaktuara në vijim:.....;

-struktura organike për periudhën objekt auditimi (2021-2023) nuk është plotësuar në numër respektivisht për vitet: 2021, vende të lira/vakante (2), 2022, vende të lira/vakante (4) dhe 2023, vende të lira/vakante (5) jo në përputhje me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019 dhe Vendimin Nr. 73, datë 24.04.2023.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar janë paraqitur komente me shkresën Nr.202/7, datë 07.05.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga Z. E. Ç, si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

Nisur nga shkresa juaj Nr. 104/2 Prot, datë 25.04.2024, “Dërgohet Projekt Raporti i Auditimit”, ku informoni mbi gjetjet dhe rekomandimet e adresuara nga ana juaj pas kontrollit financiar të kryer, ju informojmë se masat që duhet të marrë KLP shtrihen përgjatë këtij viti buxhetor të cilat

do të zbatohen gjithashtu në vijimësi. Në të njëjtën kohë ju falënderojmë për kontributin tuaj pasi auditimi i kryer ka shërbyer për institucionin tonë, si institucion i krijuar së fundmi, në vlerësimin e menaxhimit të përputhshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë, menaxhimit financiar, kontabilitetit, si dhe efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të fondeve publike dhe tashme në projektimin në të ardhmen të veprimtarisë ekonomike, por jo vetëm.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pavarësisht nga dakordësia e shprehur nga subjekti i audituar, grupi i auditimit ka arritur në përfundim të auditimit në rekomandimet përkatëse.

### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit rezultoi tejkallim i afateve për kryerjen e pagesave dhe mos respektim i parimit FIFO. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga thesari rezultojnë se për vitin 2022 dhe vitin 2023 janë 20 raste ose 4 % e total transaksioneve të likuiduara jashtë afatit 30 ditor dhe 50 raste ose 10% e total transaksioneve të likuiduara jo në respektim të rregullit hyrje e pare dalje e pare. Më konkretisht, gjatë vitit 2022 janë kryer afërsisht 230 transaksione nga këto konstatohet se 17 raste ose 7 % e total transaksioneve janë likuiduar përtej afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik. Nga këto rezultojnë 3 raste në shumën 635,369 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2021, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2022 për t'u likuiduar. Konstatohet se nga 230 transaksione, në 30 raste ose 13 % e total transaksioneve nuk është respektuar rregulli FIFO në likuidimin e faturave, duke rritur riskun potencial për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

- gjatë vitit 2023 janë kryer afërsisht 256 transaksione në vlerën 43 milion lekë. Referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi SIFQ rezultojnë 5 raste në vlerën 952,769 lekë të likuiduara përtej afatit 30 ditor. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga SIFQ rezulton se janë likuiduar 2 raste në shumën 597,517 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2022, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2023 për t'u likuiduar dhe 3 raste në vlerën 355,252 lekë i përkasin vitit 2023. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar nenin 52; Ligjin Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, nenin 7 si dhe Udhëzimin Nr. 9 datë 20.303.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kreu III “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve”; (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, në faqet 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues të KLP të merren masa për një proces të studiuar e të argumentuar të programimit buxhetor në të gjitha fazat e tij si dhe të respektimit të parimeve të mirë menaxhimit në autorizimin dhe ekzekutimin e shpenzimeve buxhetore, lidhur me afatet, radhën dhe prioritet e pagesave buxhetore.

#### **Në vazhdimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve mbi zbatimin e procedurave dhe afateve për monitorimin dhe zbatimin e buxhetit për performancën financiare mbi realizimin e programit buxhetor konstatohet se KLP nuk ka dorëzuar raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi 2021-2023 sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”. Konstatohet se KLP gjatë vitit 2021 nuk ka

përgatitur dhe dorëzuar raporti 8-mujor. Për vitin 2022 rezultoi se nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 4-mujor, 8-mujor dhe raporti 12-mujor. Për vitin 2023 nuk është dorëzuar raporti 4-mujor dhe raporti 12 mujor. Nga këto raporte gjenerohet informacion mbi performancën financiare që i nevojitet MFE për të propozuar ri-alokimin e burimeve dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 65 “Monitorimi”; Udhëzimin Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, në faqet 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për përgatitjen e informacionit mbi performancën financiare dhe dërgimin e raportit të monitorimit sipas afateve me qëllim që MF të ketë të dhënat e plota për të bërë propozimin për ri-alokimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore gjatë vitit.

### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i bërë mbi saktësinë e paraqitjes së elementëve në pasqyrat financiare rezultoi se vlerat e llogarive të aktiveve afatgjata materiale nuk rezultojnë të njëjta në formate të ndryshme të pasqyrave financiare të vitit 2022, ka pasaktësi në përlllogaritjen e amortizimit vjetor, pasaktësi në lidhje me plotësinë dhe paraqitjen e nen zërave të tyre, konkretisht llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, paraqitet e mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022, për shkak të pasaktësive në përlllogaritjen e amortizimit vjetor.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” paraqet zëra, të cilat nuk janë pjesë e inventarit ekonomik të Këshillit të Lartë i Prokurorisë, megjithëse administrohen prej tij, por janë të marra me qira, veprim ky që ka ndikuar në mbivlerësimin e kësaj klase llogarie, në fund të vitit 2022 me 200,441 lekë dhe ka rritur shpenzimet e amortizimit vjetor me 28,822 lekë. Gjithashtu për këtë klasë llogarie janë evidentuar mungesa nga inventarizimi fizik, të cilat rezultojnë të çregjistruara në kontabilitet, të pabazuara në një dokumentacion justifikues, veprim ky në kundërshtim me pikën 87 të UMF Nr.30, datë 27.12.2011.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 35-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të marrë masa për kryer sistemit e nevojshme në kontabilitet, në funksion të korrigjimit të pasaktësive të rezultuara, me qëllim pasqyrimin e vlerës së drejtë e të saktë të Aktiveve Afatgjata Materiale, kjo në përputhje me kërkesat e SKK-ve dhe të akteve nënligjore që normojnë procesin e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

### **Në vijimësi**

**3.2.Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues i Këshillit të Lartë të Prokurorisë të marrë masa në vijimësi, për të rakorduar informacionin mes pasqyrave financiare vjetore.

### **Në vijimësi**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurta të realizuar pranë KLP-së në zbatim të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr. 171, datë 14.12.2022 rezultoi se:

-Përbërja e komisionit për inventarizimin e aktiveve për 2 vite radhazi ka qenë e njëjtë për 4 nga 5 anëtarët, kjo në kundërshtim me pikën 84, të UMF Nr.30, datë 27.12.2011 ku përcaktohet se: “*Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision*”.

Nga kryerja e inventarizimit fizik kanë rezultuar mungesa në shumën 370,614 lekë në zërat e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, të cilat kanë hyrë në institucion si pjesë e marrëveshjes së nënshkruar me datën 31.12.2019. Nga procesi inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata rezultoi se nga ana e Nëpunësit Autorizues nuk janë nxjerrë urdhrat, në lidhje me masat për kompensim dhe sistemimin e diferencave, të rezultuara nga inventarizimi fizik, në kundërshtim me pikën 87 dhe 93, të UMF Nr.30, datë 27.12.2011.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ngritjen e një komisioni për saktësimin e gjendjes së inventarit dhe në rastet e mungesave të evidentohen personat përgjegjës dhe të bëhen veprimet kontabël rregulluese të bazuara në urdhrin e Nëpunësit Autorizues.

**Menjëherë**

**4.2.Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Zbatues, duhet që në regjistrimin e gjendjes reale të aktiveve, në kundër parti, të mungesave të aktiveve, të njihen të drejtat ndaj personave përgjegjës për mungesat, bazuar kjo në Urdhrin e Nëpunësit Autorizues.

**Në vijimësi**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së Llogarisë 42, “Detyrime ndaj personelit”, në bilancin kontabël të datës 31.12.2022 u bë krahasimi i listë pagesës së mbajtur nga KLP me formularin e-sig 025 të muajit Dhjetor 2022, të gjeneruar nga sistemi i tatimeve (e-filling) ku rezultuan diferenca në detyrimin e KLP-së për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punëmarrësve. Konkretisht në listë pagesën e muajit dhjetor 2022 rezulton se kontributet e sigurimeve shoqërore janë 3,125 lekë më pak dhe kontributet e sigurimeve shëndetësore 578 lekë më pak, veprim ky në kundërshtim më përcaktimet e pikave 1 dhe 2 të nenit 8 të Ligjit Nr. 9136, datë 11.09.2003, të ndryshuar. Në pasqyrën e pozicionit financiar detyrimi për TAP, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëmarrësit dhe punëdhënësit përputhen me shumat që paraqiten në formularin e-sig 025, por detyrimet për kontributet suplementare nuk paraqiten, gjithashtu paga neto nuk rezulton e paraqitur saktë, pagat neto në pasqyrën e pozicionit financiar janë nënvlerësuar me 48,146 lekë, ndërsa sigurimet suplementare, të cilat llogariten dhe deklarohen nga punëdhënësi (KLP), nuk rezultojnë të jenë të pasqyruara në pasiv të bilancit kontabël të datës 31.12.2022 çka bën që pasivi i bilancit kontabël të jetë i nënvlerësuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 41-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandimi:** Nga sektori i Financës të merren masa, që para plotësimit të listë pagesave, të cilat shërbejnë si bazë në përlllogaritjen e pagave neto, të bëhen paraprakisht rakordimet me ndalesat sipas formularit e-sig 025 dhe ndalesat e mbajtura të punëmarrësve për efekt të kontributeve suplementare të paraqiten gjithashtu në bilancin kontabël, për të mundësuar një pamje reale të detyrimeve të në fundi të vitit ushtrimor.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së të ardhurave të raportuara në Pasqyrën e Performancës Financiare për vitin 2022 (PASH) rezultoi se të ardhurat totale të raportuara në PASH janë 142,556,928 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit Nr. 331, datë 23.02.2023 me Degën e Thesarit, Tiranë paraqiten në shumën 141,986,569 lekë ose 99,821 lekë më pak për të cilat mungojnë shpjegimet në relacionin shoqëruar të bilancit vjetor të institucionit. Diferencat mes zërave të ardhurave dhe shpenzimeve sipas PASH dhe sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë, rezultojnë si më poshtë:

-Klasa 602 “*Blerje e mallrave e shërbime*” paraqitet në PASH në shumën 25,587,575 lekë ndërsa sipas akt akordimit me Degën e Thesarit, shpenzimet e realizuara për këtë klasë llogarite paraqiten në shumën 25,284,241 lekë, pra 303,334 lekë më pak.

-Klasa 606 “*Transferta për Buxhetet familjare dhe individë*”, në PASH paraqitet zero, ndërsa sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit kjo shumë paraqitet në vlerën 1,073,335 lekë.

Gjithashtu nga verifikimi i paraqitjes së pasqyrës të performancës financiare rezulton se në plotësimin e saj, totali i klasës 602 “*Blerje e mallrave e shërbime*” paraqet vetëm totalin dhe nuk paraqitet e plotësuar në nen llogaritë përkatëse.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e financës, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të marrë masa për të pasqyruar saktë në vijimësi vlerat e llogarive të klasës 601, 602 dhe 606, në pasqyrat financiare dhe të bëhen sistemimet përkatëse.

### Në vijimësi

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se: Në strukturën organike të KLP-së miratuar me Vendimin Nr. 36, datë 06.03.2019 të KLP dhe Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 të ndryshuar, nuk është përfshirë struktura e Auditit të Brendshëm, si njësi më vete. Për mungesën e auditit të brendshëm, KLP me shkresën Nr 343-2 Prot, date 27.02.2023 dërguar në MFE, mbi plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2022, ka evidentuar këtë fakt duke u shprehur për “*mungesën e sektorit të auditimit*”. Mungesa e njësisë së auditit të brendshëm është evidentuar dhe nga Drejtoria e Harmonizimit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK) pranë MFE e cila në Projekt raportin e vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për KLP-në për vitin 2023, përcjellë në KLP me shkresën Nr.4417/1 datë 22.06.2023 ka rekomanduar që “*Nëpunësi Autorizues mund të monitorojë sistemin e KB nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike*” Referuar VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” bazuar në pikën 6 gërma a) “Njësitë publike, të cilat nuk plotësojnë kriteret për krijimin e njësive të auditimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe nuk kanë varësi nga ndonjë organ epror, e sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm, nëpërmjet: marrëveshjes midis titullarëve të njësive publike përkatëse, të cilat kanë njësi të auditimit të brendshëm...”

Ngritja e strukturës së auditit të brendshëm është kërkesë dhe e Ligjit Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” i ndryshuar neni 178, pika 2, gërma “a”, Ligjit Nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar neni 3, gërma “a”, si dhe neni 10, pika 1, gërma “b”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1. Rekomandimi:** KLP të marrë masa për të siguruar realizimin e shërbimit të auditimit në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar dhe përcaktimeve të VKM Nr.83 Datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar.

### Menjëherë

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i strukturës organike rezultoi se: për periudhën objekt auditimi (2021-2023) struktura organike është e pa plotësuar në numër, respektivisht:

-Në Dhjetor 2021, vende të lira/vakante (2), për pozicionet: drejtor kabineti (1) dhe nëpunës informacioni (1).

-Në Dhjetor 2022, vende të lira/vakante (4) për pozicionet: Drejtor Departamenti i Shërbimeve Ligjore (1), Këshilltar ligjor në Drejtorinë e Njësive të Mbështetjes së Komisioneve (1), teknik mirëmbajtje (2).



-Dhjetor 2023, vende të lira/vakante (5) për pozicionet: këshilltar ligjor në Drejtorinë e Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve (1), specialist i burimeve njerëzore (1), specialist TIK (1) dhe shofer (1).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 50-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për plotësimin e vendeve vakante duke ndjekur procedurën e konkurrimit për nëpunësit civil dhe lidhjen e kontratës së punës për punonjës që trajtohen me Kodin e Punës.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi menaxhimin e riskut në funksion të Ligjit Nr.10296, datë 08. 07. 2010 (ndryshuar) rezultoi se: KLP nuk ka hartuar dhe miratuar regjistrin e riskut për institucionin për vitin 2021-2022, jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 (ndryshuar), neni 8, germa “a” dhe neni 21, pika 2. Një konstatim i tillë dhe pse i raportuar nga vetë KLP, në pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar, dërguar në MFE me shkresën Nr.343/2 Prot, datë 27.02.2023, nuk është shoqëruar me marrjen e veprimeve korrigjuese megjithëse institucioni ka hartuar Manualin për strategjinë e Menaxhimit të riskut, miratuar me Nr.2717/1, datë 12.12.2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 51-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, për hartimin dhe miratimin e regjistrit institucional të riskut, me qëllim funksionimin në tërësi të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

#### Menjëherë

## V.ANEKSE

*Aneksi Nr. 1 “Faturat e likuiduara gjatë vitit 2022 përtej afatit 30 ditore dhe faturat e paguara jo në respektim të rregullit FIFO”*

Tabela Fatura të likuiduara jashtë afatit 30 ditore (në lekë)

Përshkrimi	Furnitori	Shuma	Data furnitorit	Data urdhër shpenzimit	Vonesa
Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	Ndërmarrja industriale Nr 1	7,395	9/30/2021	6/17/2022	-260
Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	Ndërmarrja industriale Nr 1	549,148	10/1/2021	6/17/2022	-259
Ujë	Ndërmarrja industriale Nr 1	78,826	10/1/2021	6/17/2022	-259
Shërbime telefonike	V. A	111,176	6/3/2022	7/13/2022	-40
Shërbime të printimit dhe publikimit	P. S	314,016	7/19/2022	9/2/2022	-45
Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	Ndërmarrja industriale Nr 1	40,616	7/27/2022	12/28/2022	-154
Shërbime telefonike	V. A	114,534	8/7/2022	9/21/2022	-45
Shërbime të tjera	M. G. G	20,000	9/15/2022	10/26/2022	-41
Shërbime telefonike	V. A	106,635	10/5/2022	11/24/2022	-50
Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	Ndërmarrja industriale Nr 1	1,800	10/7/2022	12/28/2022	-82
Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	Ndërmarrja industriale Nr 1	6,713	10/11/2022	12/28/2022	-78
Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	Ndërmarrja industriale Nr 1	6,712	10/11/2022	12/28/2022	-78
Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	Ndërmarrja industriale Nr 1	6,713	10/11/2022	12/28/2022	-78
Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	Ndërmarrja industriale Nr 1	39,780	10/31/2022	12/28/2022	-58
Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	Ndërmarrja industriale Nr 1	11,890	11/3/2022	12/28/2022	-55

Shpenzime për pritje e përcjellje	C. C	80,000	11/3/2022	12/27/2022	-54
Shërbime telefonike	P. Sh sh.a	14,800	11/4/2022	12/28/2022	-54
Shërbime telefonike	V. A	104,308	11/4/2022	12/27/2022	-53
Karburant dhe vaj	K.	156,597	11/8/2022	12/27/2022	-49
Ujë	Ndërmarrja industriale Nr 1	17,291	11/14/2022	12/28/2022	-44

Burimi: Sistemi i thesarit përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Tabela Pagesat sipas muajve gjatë vitit 2022 (në mijë lekë)

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Janar	9,223	1,922	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	11,145
Shkurt	-	6,625	8,390	-	-	-	-	-	-	-	-	-	15,015
Mars	-	-	9,345	446	-	-	-	-	-	-	-	-	9,791
Prill	-	-	-	9,200	720	-	-	-	-	-	-	-	9,920
Maj	-	-	-	-	9,960	214	-	-	-	-	-	-	10,174
Qershor	-	-	-	-	-	10,208	790	-	-	-	-	-	10,998
Korrik	-	-	-	-	-	-	10,179	543	841	-	-	41	11,605
Gusht	-	-	-	-	-	-	-	8,512	1,236	-	-	-	9,749
Shtator	-	-	-	-	-	-	-	-	9,257	991	-	-	10,248
Tetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8,913	595	62	9,569
Nëntor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	9,736	594	10,331
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10,571	10,571
<b>Total</b>	<b>9,223</b>	<b>8,547</b>	<b>17,735</b>	<b>9,646</b>	<b>10,680</b>	<b>10,422</b>	<b>10,970</b>	<b>9,056</b>	<b>11,335</b>	<b>9,904</b>	<b>10,331</b>	<b>11,268</b>	<b>129,116</b>

Burimi: Sistemi i thesarit, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Tabela Faturat e likuiduara jo në respektim të rregullit FIFO (në lekë)

Furnitori	Shuma	Data e furnitorit	Data e urdhër-shpenzimit	Data ekzekutimit
A.C.R	240,000	1/31/2022		2/10/2022
V. A	156,084	2/3/2022		3/11/2022
A.C.R	240,000	2/28/2022		3/18/2022
V. A	149,677	3/4/2022		3/18/2022
V. F	80,000	3/8/2022		3/18/2022
Ndërmarrja industriale Nr 1	7,395	3/9/2022		4/6/2022
Ndërmarrja industriale Nr 1	352,750	3/23/2022		4/6/2022
E.	56,000	3/25/2022		4/6/2022
V. A	141,519	4/5/2022		4/19/2022
K.	607,500	4/29/2022		5/23/2022
V. A	124,565	5/5/2022		5/23/2022
P. S	249,792	5/10/2022		5/24/2022
A. M. C	25,260	5/23/2022		6/7/2022
K.	454,085	6/1/2022		6/14/2022
V. A	111,176	6/3/2022		7/13/2022
V. A	115,074	7/6/2022		8/4/2022
P. S	314,016	7/19/2022		9/2/2022
K.	429,400	7/26/2022		9/2/2022
E. O	62,160	7/26/2022		8/9/2022
Ndërmarrja industriale Nr 1	40,616	7/27/2022		12/28/2022
Ndërmarrja industriale Nr 1	49,640	8/3/2022		9/2/2022
V. A	114,534	8/7/2022		9/21/2022
Ndërmarrja industriale Nr 1	23,415	8/9/2022		9/2/2022
M. R. C	75,862	8/31/2022		9/20/2022
A.	29,800	8/31/2022		9/20/2022
M. G. G	20,000	9/15/2022		10/26/2022
T.	23,000	9/16/2022		10/7/2022
I. O	57,611	9/26/2022		10/17/2022

V. A	106,635	10/5/2022	11/24/2022	11/25/2022
Ndërmarrja industriale Nr 1	1,800	10/7/2022	12/28/2022	12/30/2022

Burimi: Sistemi i thesarit, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Aneksi Nr.2 “ Faturat e likuiduara gjatë vitit 2023 përtej afatit 30 ditor” dhe “ Faturat e likuiduara gjatë vitit 2023 jo në respektim të rregullit FIFO”.

Tabela Faturat e likuiduara jashtë afatit 30 ditor ( në mijë lekë)

Furnitori	Vlera	Data e regjistrimit	Data e ekzekutimit	Përshkrimi i Faturës	Vonesa
Ndërmarrja industriale Nr 1	384	1/12/2023	1/18/2023	Këshilli i Larte i Prokurorisë pagese shërbim roje akt marrëveshje Nr 54/1 date 17.12.2020 fat Nr 303/2022 date 31.10.2022	79
Ndërmarrja industriale Nr 1	212	1/12/2023	1/13/2023	Këshilli i Larte i Prokurorisë shërbim furnizim me energji akt marrëveshja Nr 54/1 date 17.12.2020 fat Nr 326/2022 date 15.11.2022	59
<b>Totali i fatura 2022</b>	<b>596</b>				
Drejtori e shërb qeveritare	117	7/20/2023	9/1/2023	Këshilli i Larte i Prokurorisë shërbim pritje program 19.06.2023 urdhër Nr 133 date 27.06.2023 fat Nr 914 date 05.07.2023	43
Drejtori e shërb qeveritare	165	7/20/2023	9/1/2023	Këshilli i Larte i Prokurorisë shërbim pritje program 1651 date 07.07.2023 urdhër Nr 138 date 10.07.2023 fat Nr 941 date 12.07.2023	43
I. O	73	7/20/2023	9/1/2023	Këshilli i Larte i Prokurorisë shërbim fotokopje pritnim kont vazhdim Nr 1177/4 date 15.07.2022 fat Nr 9752/2023 date 13.07.2023	43
<b>Totali i faturave të vitit 2023</b>	<b>355</b>				

Burimi: Sistemi i thesarit, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Tabela Pagesat sipas muajve gjatë vitit 2023 (në mijë lekë)

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Janar	3,685	642	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,327
Shkurt	-	1,391	1,526	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,917
Mars	-	-	698	999	-	-	-	-	-	-	-	-	1,697
Prill	-	-	-	3,072	436	-	-	-	-	-	-	-	3,508
Maj	-	-	-	-	1,482	348	-	-	-	-	-	-	1,830
Qershor	-	-	-	-	-	1,854	688	-	-	-	-	-	2,542
Korrik	-	-	-	-	-	-	522	1,034	355	-	-	-	1,912
Gusht	-	-	-	-	-	-	-	4,541	1,608	-	-	-	6,149
Shtator	-	-	-	-	-	-	-	-	5,537	-	-	-	5,537
Tetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3,854	-	-	3,854
Nëntor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,122	-	1,122
Dhjetor	2,222	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5,973	8,194
<b>Total</b>	<b>5,906</b>	<b>2,032</b>	<b>2,224</b>	<b>4,071</b>	<b>1,918</b>	<b>2,202</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>7,501</b>	<b>3,854</b>	<b>1,122</b>	<b>5,973</b>	<b>43,590</b>
							<b>5,576</b>						

Burimi: Sistemi i thesarit, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së

Tabela Faturat e likuiduara jo në respektim të parimit FIFO (në lekë)

Furnitori	Vlera	Data regjistrimit	Data ekzekutimit	Përshkrimi
K.	411,999	1/19/2023	2/1/2023	Karburant dhe vaj
I. O	82,734	2/17/2023	3/1/2023	Shërbime te printimit dhe publikimit

A.M. C	36,876	2/17/2023	3/1/2023	Shpenzime te tjera transporti
A.	609,428	3/6/2023	4/3/2023	Shpenzime për qiramarrje mjetes transporti
Ndërmarrja industriale Nr 1	389,878	3/7/2023	4/3/2023	Elektricitet
Ndërmarrja industriale Nr 1	436,489	4/19/2023	5/2/2023	Shërbime te pastrimit dhe gjelbërimit
K.	348,000	5/22/2023	6/1/2023	Karburant dhe vaj
Ndërmarrja industriale Nr 1	442,782	6/9/2023	7/3/2023	Shërbime te pastrimit dhe gjelbërimit
A.	33,900	7/7/2023	8/1/2023	Shërbime te tjera
Ndërmarrja industriale Nr 1	384,712	7/7/2023	8/1/2023	Shërbime te sigurimit dhe ruajtjes
Drejtori e sherb qeveritare	117,000	7/20/2023	9/1/2023	Shpenzime për pritje e përcjellje
Drejtori e sherb qeveritare	165,000	7/20/2023	9/1/2023	Shpenzime për pritje e përcjellje
I. O	73,252	7/20/2023	9/1/2023	Shërbime te printimit dhe publikimit
Ndërmarrja industriale Nr 1	405,586	8/7/2023	9/1/2023	Elektricitet
A.M.C	30,186	8/8/2023	9/1/2023	Shpenzime te tjera transporti
P. A sh.p.k	37,245	8/8/2023	9/1/2023	Pjese këmbimi, goma dhe bateri
A.	33,900	8/8/2023	9/1/2023	Shërbime te tjera
P. A sh.p.k	36,852	8/8/2023	9/1/2023	Pjese këmbimi, goma dhe bateri
K.	376,037	8/8/2023	9/1/2023	Karburant dhe vaj
Ndërmarrja industriale Nr 1	30,600	8/8/2023	9/1/2023	Te tjera materiale dhe shërbime speciale

*Burimi: Sistemi i thesarit, përpunuar nga grupi auditues i KLSH-së*

### *Aneksi 3. “Pasqyra e llogaritjes së materialitetit sasior”*

<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>141 886 748</b>
Materialiteti në %	1%
Materialiteti në vlerë	1 418 867
Gabimi I lejuar (%)	10%
Gabimi I lejuar në vlerë	141 886,75

*Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.*

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**